



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 584 Akti

V E N D I M

Nr. 4, datë 14.7.2021

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 12.7.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim çështjen e subjektit të rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, dhe

VËREN:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, aktualisht me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Valbona Sanxhaktari. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 17.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues, komisioner Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Riselda Fishta.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 22.6.2021 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, si dhe njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë, apo të kërkojë marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni me anë të postës elektronike të datës 22.6.2021.

9. Subjekti i rivlerësimit, në datën 7.7.2021, dërgoi nëpërmjet postës elektronike parashtrime në lidhje me rezultatet e hetimit, si dhe paraqiti prova e dokumentacion mbështetës.

10. Pas administrimit të parashtrimeve të subjektit, provave dhe dokumentacionit, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore¹.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 8.7.2021.

12. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 12.7.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

13. Subjekti i rivlerësimit, znj. Riselda Fishta, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të

¹Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 8.7.2021.

kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

14. Znj. Riselda Fishta ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Ajo u është përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

15. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

17. Referuar vendimit nr. 2/2017², të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

18. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit

² “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i papabuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

nga Prokuroria e Përgjithshme; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; si dhe (g) shpjegimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore.

19. Komisioni vlerëson që në këtë vendim të trajtojë vetëm vlerësimin e subjektit në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, bazuar në nenin E dhe pikën 2 të nenit E të Aneksit Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

20. Në lidhje me dy kriteret e tjera Komisioni do të shprehet në vendimin përfundimtar, pasi subjekti të ketë përfunduar programin e edukimit njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës dhe të jetë testuar për aftësitë e saj.

V. VLERËSIMI PROFESIONAL

21. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura në Komision;
- dosjet e administruara me iniciativë të Komisionit;
- dokumentacionin e administruar nga Prokuroria e Përgjithshme.

22. Nga verifikimi i dokumenteve ligjore të dorëzuara nga subjekti nuk janë konstatuar problematika.

23. PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE PËR PROKUROREN RISELDA FISHTA, TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

23.1. Nga analiza e kryer në lidhje me dosjet nr. 1, 4 dhe 5 nuk kanë rezultuar problematika.

23.2. Dosja nr. 2 – vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. **, të vitit 2014”, datë 21.4.2014

23.2.1. Oficeri i policisë gjyqësore, me relacionin e datës 10.7.2014, ka parashtruar shpjegimet mbi faktin dhe provat, si dhe sugjerimin mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve. Konkretisht, ka sugjeruar dërgimin e çështjes për gjykim. Me shkresën nr. ***, datë 6.8.2014, të Komisarariatit të Policisë Lezhë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë janë dërguar materiale shtesë, konkretisht, shkresat kthim përgjigje të Bashkisë Lezhë.

23.2.2. Në fashikull është administruar edhe “relacioni mbi përfundimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, nga oficeri i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, datë 20.4.2015. Në këtë akt oficeri i policisë gjyqësore ka sugjeruar “pushimin e procedimit penal”.

23.2.3. Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, për një periudhë më shumë se 8-mujore nuk ka kryer asnjë veprim hetimor.

23.2.4. Pas kalimit të barrës së provës subjekti pretendoi se vonesat në kryerjen e veprimeve hetimore kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së oficerëve të policisë gjyqësore të Komisarariatit

Lezhë, të cilët kanë shfaqur neglizhencë në kryerjen e detyrave të caktuara nga subjekti në cilësinë e prokurorit të çështjes.

Subjekti pretendon se dosja i është dhënë për plotësim Komisarariatit të Policisë Lezhë, pasi mungonin tabelat fotografike, të cilat janë administruar në datën 30.1.2015. Subjekti citon se vonesat e konstatuara nga Komisioni nuk kanë sjellë ndonjë dëm apo pasojë juridike, duke qenë se nuk ka pasur persona të regjistruar nën hetim apo të dëmtuar nga vepra penale.

23.2.5. Shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë barrë prove nuk janë bindëse. Ajo nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokumentacion provues për të provuar se dosja i është dërguar për plotësim Komisarariatit të Policisë Lezhë dhe është kthyer në datën 20.4.2015 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Nga aktet e gjendura në dosje rezulton se tabelat fotografike mbajnë datën 24.5.2014, por dhe në rast se këto tabela nuk ishin administruar, subjekti duhej të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme që ato të ishin pjesë e procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes në një kohë sa më të shkurtër, duke marrë në konsideratë faktin që procesverbali është hartuar që në datën 28.4.2014. Dokumenti i fundit i administruar nga subjekti në dosjen hetimore nga Komisarirati i Policisë Lezhë mban datën 6.8.2014 dhe është marrë nga subjekti në datën 1.9.2014. Subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, është përgjegjëse për drejtimin e veprimtarisë hetimore, përcaktimin e detyrave të oficerëve të policisë gjyqësore dhe ndjekjen e zbatimit të tyre.

Për rrjedhojë, konstatohet se subjekti, për një periudhë 8-mujore (7-mujore nëse i referohemi pretendimeve të saj) pa asnjë arsye nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, duke treguar aftësi dhe sjellje të cekëta, të cilat konsiderohen si mangësi profesionale.

23.2.6. Subjekti, me vendimin datë 21.4.2015, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në bazë të nenit 328, pika 1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale ka vendosur pushimin e procedimit. Rezulton se në vendim pasqyrohen rrethanat e faktit penal dhe provat e administruara për efekt të hetimit të çështjes penale. Akti është i arsyetuar. Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar shkaqet ligjore të pushimit të çështjes, si dhe ka interpretuar elementët e figurës së veprës penale objekt hetimi, duke iu referuar ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006. Interpretimi i elementëve të veprës penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit të Procedurës Penale nga subjekti i rivlerësimit, nuk është në përputhje me Qarkoren e Prokurorit të Përgjithshëm, nr. ***/ prot., datë 19.9.2014, me lëndë “për kuptimin dhe zbatimin e unifikuar të nenit 199/a të Kodit Penal”. Sipas kësaj Qarkoreje, në interpretimin e figurës së veprës penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, prokurorët nuk duhet t’i referohen parashikimeve të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, por ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

23.2.7. Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, sqaroi se në vendimin e pushimit ka argumentuar se ndërtimit i mungonin elementët strukturorë të domosdoshëm për t’u konsideruar i konsumuar në aspektin penal. Pra, procedimi nuk është pushuar në thelb për shkak të kuptimit të ligjit për legalizimet, pavarësisht se është cituar në vendim, por se objekti nuk përmbushte kushtet për t’u konsideruar i tillë (pavarësisht masave administrative që duhet të marrë Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor).

23.2.8. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit lidhur me konstatimin e mësipërm janë bindëse dhe përputhen me përmbajtjen e vendimit të pushimit të procedimit penal.

23.2.9. Baza ligjore e vendimit të pushimit të procedimit penal, neni 328, pika 1, germa “b”, është identifikuar drejt, duke marrë në konsideratë arsyetimin e subjektit të rivlerësimit. Në vendim prokurori ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes të palëve të interesuara me të, me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatë. Vendimi mban nënshkrimin e subjektit. Me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2016, vendimi i është njoftuar shtetasit Z. Ç.

23.3. Vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015”, datë 10.10.2015.

23.3.1. Nga hetimi ka rezultuar se lokali ishte në pronësi të personit nën hetim A. P, ku sipas deklaramëve të tij kishte 5 ditë që e kishte hapur aktivitetin dhe sendet e sekuestruara i kishte marrë nga një lokal tjetër. Personi nën hetim nuk ka qenë i pajisur me NIPT për të ushtruar aktivitetin e lojërave të fatit. Nga aktekspertimi teknik nr. ***, i datës 8.7.2015 (ardhur në prokurori në datën 10.9.2015), i kryer nga specialistët e Njësisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit pranë Ministrisë së Financave, ka rezultuar se: *“Televizori plazma 32, i markës LG i sekuestruar, nuk klasifikohet si pajisje që shërben për lojëra fati...*

*Njësia qendrore (PC) e sekuestruar, hyn në kategorinë për zhvillim aktiviteti lojëra fati, në kategorinë ‘baste sportive’. Në njësinë qendrore ekzistojnë të dhëna software për organizimin e basteve sportive dhe vendosja e basteve realizohej nëpërmjet linkut www.***.com. Konstatohet që gjendja teknike e tyre ishte e rregullt. Bazuar në platformën e vendosjes së basteve sportive nëpërmjet internetit, të dhënat lidhur me shumën e përfituara nga ky aktivitet ruhen në kompjuter qendrorë (server), prej të cilëve bëhet e mundur organizimi i aktivitetit. Për këto arsye në njësinë qendrore nuk rezultojnë të dhëna lidhur me aktivitetin e tyre, pasi ato kanë shërbyer si terminale”.*

Në datën 10.10.2015 subjekti ka përpiluar “vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015”, në mbështetje të nenit 328, paragrafi 1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale, ku ka vendosur pushimin e procedimit.

Në lidhje me këtë procedim ka rezultuar se:

- i. Baza ligjore e identifikuar, neni 328/1, germa “b”, ka lapsus. Referuar argumenteve të parashtruara në pjesën arsyetuese të vendimit, baza ligjore është neni 328/1, germa “dh”, kur parashikohet se: *“Nuk provohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale”.*
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka disponuar në vendimin përfundimtar për sendet e sekuestruara, sipas parashikimeve të neneve 190 dhe 217 të Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, sqaroi se sendet e sekuestruara nuk i përshtaten kushteve për të realizuar organizimin e lojërave të fatit, për këtë arsye, bazuar në nenin 328/1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale është vendosur pushimi i procedimit, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Lidhur me konstatimin mbi mungesën e disponimit në vendim përfundimtar mbi sendet e sekuestruara, subjekti sqaron se në shumë raste kthimi i sendeve bëhet në formën e urdhrin të veçantë përpara përfundimit të procedimit penal (kur nuk ka më rëndësinë e provës materiale) ose në formën e disponimit për kthimin e sendit në vendimin e pushimit ose edhe pasi është marrë vendimi i pushimit nga prokurori. Në këtë rast kthimi i sendit sipas subjektit është bërë në mënyrë të pavarur me vendimin e pushimit.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se në lidhje me bazën ligjore shpjegimet e saj janë bindëse, duke u bazuar në bindjen e brendshme të saj dhe, për rrjedhojë, nuk mund të vlerësojë themelin e çështjes. Ndërkohë, në lidhje me disponimin për sendet e sekuestruara, subjekti, bazuar në nenin 190³ të Kodit të Procedurës Penale kishte detyrimin ligjor që në vendimin e pushimit të caktonte se çfarë duhej të bëhej me sendet e sekuestruara, detyrim i cili nuk është zbatuar prej saj, duke treguar njohuri të cekëta, që konsiderohen si mangësi profesionale.

24. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE

24.1. Në dosjen personale të subjektit të rivlerësimit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë janë administruar dy urdhra të Prokurorit të Përgjithshëm “për dhënie mase disiplinore”.

24.2. Komisioni administroi dokumentacionin⁴ për masat disiplinore të marra nga subjekti i rivlerësimit. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se me urdhrin nr. ***, datë 1.12.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjektit të rivlerësimit i është dhënë masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra e prokurorit” për shkeljet e konstatuara.

Procedimi disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar mbi bazën e rezultateve të kontrollit të ushtruar në veprimtarinë e subjektit, me urdhrin nr. ***, datë 2.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për ushtrimin e kontrollit në veprimtarinë e prokurores Riselda Fishta pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Nga analizimi i aktkontrollit ka rezultuar se:

1. Subjekti, pa shkaqe të përligjura dhe në mënyrë të përsëritur (shihni tabelat bashkëlidhur aktkontrollit), në mosfillimet e procedimeve penale ka tejkalluar afatet e marrjes së vendimeve të përcaktuara në udhëzimet nr. 241 datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, si dhe nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar.

Subjekti, në rastet e vendimeve të mosfillimit, ka vonuar nxjerrjen e tyre në mënyrë të pamotivuar, pasi nuk janë kryer menjëherë verifikime të mundshme kur ishte e nevojshme. Subjekti ka vonuar vendimmarrjen edhe kur nuk kishte nevojë për asnjë lloj verifikimi.

- i. Në vitin 2012, nga 23 fashikuj për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, për 18 kallëzime vendimi është marrë brenda afateve, ndërsa për 5 prej tyre vendimi është marrë jashtë afatit. Në dy raste tejkallimi i afatit ka qenë përkatësisht 32 ditë dhe 66 ditë.

³ Në vendimin përfundimtar ose në atë të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori caktojnë se çfarë duhet bërë me provat materiale, duke urdhëruar: (a) sendet që kanë shërbyer ose ishin caktuar si mjet për kryerjen e veprës penale dhe sendet që përbëjnë përfitimin e nxjerrë nga ajo ose shpërblimin e dhënë a të premtuar për kryerjen e saj, merren dhe i kalojnë shtetit, përveç rastit kur këto sende janë të personave që nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale; (b) sendet, mbajtja ose qarkullimi i të cilave është i ndaluar, u dorëzohen enteve përkatëse ose zhduken; (c) sendet që nuk kanë asnjë vlerë zhduken; (ç) sendet e tjera u kthehen personave që u takojnë dhe, kur ka konflikt për pronësinë e tyre, ruhen gjersa ai të zgjidhet nga gjykata. 2. Provat materiale mund t’u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të procedimit, kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes.

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 28.4.2021, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 5.5.2021, e Prokurorisë së Përgjithshme.

- ii. Në vitin 2013, nga 49 fashikuj për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, për 15 kallëzime vendimi është marrë brenda afateve, ndërsa për 34 prej tyre jashtë afatit.

Në 5 raste tejkalimi i afatit ka qenë mbi 20 ditë, në 5 raste mbi 40 ditë, në 3 raste mbi 70 ditë, në një rast 109 ditë, në një rast 126 ditë, në një rast 142 ditë, në një rast 189 ditë dhe në 17 raste deri në 20 ditë.

- iii. Në katërmujorin e parë të vitit 2014, nga 11 fashikuj për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, për 6 kallëzime vendimi është marrë brenda afateve, ndërsa për 5 prej tyre vendimi është marrë jashtë afatit.

Në 2 raste tejkalimi i afatit ka qenë 33 ditë, në 1 rast 126 ditë dhe në 1 rast 62 ditë.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, në lidhje me këto vonesa, sqaron se shpesh herë kanë ardhur si pasojë e administrimit me vonesë të akteve të referimit (si p.sh. tabela fotografike ose një akt mjeko-ligjor, i cili konkludon nëse materiali duhet ose jo të regjistrohet), të cilat jo gjithmonë varen nga mundësia dhe vullneti i prokurorit. Gjithashtu, subjekti pretendon se është e pabazuar ligjërisht që një fakt që dihet që në veprimet verifikuese të kallëzimit që nuk është vepër penale të regjistrohet si procedim vetëm se ka kaluar afati 15-ditor i disponimit me vendim mosfillimi. Dihet se një fakt regjistrohet si procedim penal kur ka të dhëna për kryerjen e një vepre penale dhe jo pa asnjë arsye ligjore penale të regjistrohet se ende nuk ka ardhur akti përkatës dhe kalon afati.

Shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë rezultat hetimi nuk janë bindëse. Është detyrë e prokurorit që të marrë të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e veprimeve hetimore dhe administrimin e provave të nevojshme. Kallëzimi nuk mund të lihet pa u regjistruar dhe pa kryer asnjë veprim për një kohë të gjatë. Nuk mund të mosregjistrohet një kallëzim kur afatet janë tejkualuar dhe aq më tepër kur këto afate janë tejkualuar me 66 ditë, 126 ditë apo 189 ditë, siç është konstatuar më lart. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti, në rastet e vendimeve të mosfillimit, ka vonuar nxjerrjen e tyre në mënyrë të pamotivuar, pasi nuk janë kryer menjëherë verifikime të mundshme kur ishte e nevojshme, gjithashtu edhe kur nuk kishte nevojë për asnjë lloj verifikimi subjekti ka vonuar nxjerrjen e vendimit duke tejkualuar afatet.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

2. Në raste të konsiderueshme edhe vendimet e pezullimit të hetimeve nuk janë marrë brenda afateve të parashikuara në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale. Nga 58 vendime pezullimi, 20 prej tyre janë marrë në tejkalim të afateve.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, argumenton se pezullimi, si një nga vendimet e prokurorit gjatë hetimeve paraprake, nuk lidhet me afate hetimore, por ka për afat të përgjithshëm ato që parashikon Kodi Penal për parashkrimin e ndjekjes penale në varësi të marzhit të dënimit që sanksionon dispozita konkrete për të cilën është regjistruar procedimi penal. Në kuptim të nenit 323 të Kodit të Procedurës Civile, afati hetimor fillon të ecë nga momenti që në regjistrin e procedimeve penale regjistrohet emri i personit që nga provat e akumuluar është i dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në rastin e vendimeve të pezullimit,

kanë vlerë afatet e përgjithshme të ndjekjes penale ose afatet e parashkrimit të veprës penale. Në këtë kontekst, është e gabuar gjetja e kontrollit të Prokurorisë së Përgjithshme që konkludon se vendimet e pezullimit nuk janë marrë brenda afatit të parashikuar nga neni 323 i Kodit të Procedurës Penal, pasi ky nen dhe afatet që ai parashikon janë afate për veprat penale me autor, me person të dyshuar.

Në lidhje me këtë rezultat, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit në lidhje me faktin se vendimet e pezullimit nuk kanë një afat të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale janë të drejta, por ndërkohë rezulton se nga ana e saj nuk janë kryer në kohë veprimet e nevojshme hetimore, duke u zvarritur hetimet, ku në disa raste kanë vijuar për periudha nga 8 muaj deri në 14 muaj (referohuni tabelës nr. * të aktkontrollit).

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti, në rastet e vendimeve të pezullimit, ka vonuar nxjerrjen e tyre në mënyrë të pamotivuar, pasi nuk ka kryer menjëherë verifikime të mundshme kur ishte e nevojshme.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

3. Në raste të përsëritura janë zvarritur për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore, hetimet paraprake. Zvarritje të tilla janë bërë për neglizhencë të subjektit, pasi ka raste që nuk i ka deleguar për kryerje të veprimeve hetimore tek oficerët e policisë gjyqësore, por edhe në raste delegimi pas sugjerimit të këtyre të fundit, subjekti nuk u ka dhënë zgjidhje procedimeve për periudha të gjata kohore.

i. Subjekti ka vendosur pushimin e hetimeve për 51 procedime penale. Vetëm për 21 procedime penale hetimet kanë përfunduar brenda afatit 3-mujor të përcaktuar nga neni 323 i Kodit të Procedurës Penale, ndërsa 31 prej tyre kanë përfunduar tej afatit ligjor.

Në 8 raste tejkalimi i afatit ka qenë mbi 5 muaj, në 3 raste mbi 9 muaj, në 3 raste mbi 6 muaj, në 8 raste nën 4 muaj, në 2 raste 1 vit, në 1 rast 15 muaj dhe në 5 raste mbi 7 muaj.

ii. Procedimet penale janë mbajtur nën hetim për periudha të gjata kohore, pa u kryer veprime hetimore në dinamikë dhe vijueshmëri.

Lidhur me zvarritjet e evidentuara në hetimet paraprake, pas kalimit të barrës së provës, subjekti argumenton se në të shumtën e procedimeve penale, të referuara si zvarritje tej afatit të parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal, janë procedime penale pa persona të dyshuar, d.m.th. janë referime pa emra të regjistruar në regjistrin e procedimit penal dhe, si pasojë, për to nuk mund të vlejë baza ligjore e nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo bazë ligjore shërben vetëm për procedimet penale me emër, të cilëve legjislatori i ka dhënë një afat më të shkurtër kohor. Procedimet penale të referuara si shkelje tej afatit tremujor nuk kanë qenë procedime penale me afate nga ata të referuara padrejtësisht nga kontrolli në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale, por kanë qenë pjesa më e madhe, pa person të dyshuar dhe për të cilat ka qenë e nevojshme kryerja e veprimeve procedurale në kohë. Në shumë nga procedimet penale të konstatuara vonesat kanë qenë për shkak të vonesës së akteve ose personat që ka lindur nevoja të pyeten janë larg qendrave të banimit, nga vonesat në administrimin e akteve policore,

të cilat në vetvete kanë ndikuar në zvarritjen e hetimit. Shumë vonesa janë shkaktuar edhe nga veprimet e oficerëve që, megjithëse kalojnë afatin e delegimit të prokurorit, të dhënë verbalisht ose me shkrim, përsëri nuk kryejnë veprimet e deleguara dhe ky fakt gabimisht i adresohet prokurorit.

Neni 323 i Kodit të Procedurës Penale, afatet e hetimit në kuptimin e ngushtë i lidh me regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, ndërkohë, vonesat e konstatuara më lart lidhen me faktin se subjekti ka zvarritur hetimet për periudha të gjata kohore dhe pa arsye ligjore si rrjedhojë e mosdelegimit për kryerjen e veprimeve hetimore tek OPGJ-ja ose të mosdhënies së zgjidhjes së procedimeve për periudha të gjata kohore dhe pas sugjerimeve të këtij të fundit. Pra, rezultati i hetimit nuk është lidhur ngushtësisht me afatin 3-mujor të parashikuar nga neni 323, por ky afat është marrë si referencë me qëllim vënien në dukje të vonesave nga subjekti pa shkaqe të arsyeshme, duke sjellë si pasojë zvarritjen e hetimeve. Shpjegimet e subjektit në lidhje me vonesat nuk janë bindëse, pasi është detyrë e prokurorit që të marrë të gjitha masat për kryerjen e veprimeve hetimore në kohë. Subjekti nuk mund të shkarkojë nga përgjegjësia veten e saj, duke deklaruar si arsye vonesat në administrimin e akteve, veprimet e oficerëve të policisë gjyqësore (të cilët në bazë të nenit 30/2 të Kodit të Procedurës Penale⁵ janë të detyruar të zbatojnë urdhrat e prokurorit) apo largësia e banimit të personave që duheshin pyetur.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti, në raste të përsëritura, ka zvarritur për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore, hetimet paraprake.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit nr. ***2012, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë 6 muaj e 25 ditë.

Në lidhje me këtë procedim subjekti sqaron se në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë është regjistruar procedimi penal nr. ***/2012, për veprën penale “prerje e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Në datën 12.12.2012 është disponuar për kthimin e sendit provë materiale shtetasit të cilit i është sekuestruar, duke lënë në ruajtje lëndën drusore. Në datën 10.2.2013 është bërë e mundur administrimi i tabelës fotografike të këqyrjes së lëndës së sekuestruar nga oficeri i policisë gjyqësore. Në datën 10.4.2013 është marrë vendimi për shpërblimin e ekspertit tekniko-vlerësues të lëndës drusore objekt sekuestrimi dhe është administruar kopje e lejes së shfrytëzimit të pyjeve nr. *, datë 24.5.2012, nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Kukës. Në datën 22.7.2013 prokuroria ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***/2012, për veprën penale të mësipërme, pasi fakti nuk përbënte vepër penale.

Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit vëren se ato nuk janë bindëse.

Nga verifikimi i dosjes hetimore rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur fillimin e hetimeve në datën 15.10.2012.

⁵ Policia gjyqësore kryen çdo veprim hetimor që i është urdhëruar ose i deleguar nga prokurori.

Subjekti pretendon se në datën 10.4.2013 është administruar kopja e lejes së shfrytëzimit të pyjeve nr. *, datë 24.5.2012, ndërkohë që është administruar me “procesverbalin e këqyrjes dhe marrjes së dokumenteve provë materiale”, të datës 26.10.2012.

Në datën 10.2.2013 subjekti pretendon se ka administruar tabelën fotografike të këqyrjes së lëndës së sekuestruar nga oficeri i policisë gjyqësore. Nga shqyrtimi i tabelës fotografike rezulton se shkrimi i datës në dokumentin “tabelë fotografike” në përmbajtje të dosjes hetimore të depozituar nga subjekti ishte shkruar me laps, fakt i cili vërtetohet me përdorimin e gomës fshirëse mbi datën e dokumentit.

Subjekti deklaron se në datën 10.4.2013 është marrë vendimi për shpërblimin e ekspertit tekniko-vlerësues, por ky vendim nuk përbën veprim hetimor, në kuptim të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk mund të përdoret si provë në procedim.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë mbi 6 muaj, për rrjedhojë, nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në kohë, si dhe nuk ka kryer asnjë veprim hetimor pas regjistrimit të procedimit penal, duke treguar aftësi dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit nr. ***/2012, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë 7 muaj e 20 ditë.

Në lidhje me këtë procedim subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka listuar veprimet hetimore të kryera prej saj.

Komisioni vlerëson në lidhje me këtë procedim se subjekti nuk ka kryer në kohë dhe në dinamikë veprimet hetimore, pasi rezulton se për periudha të gjata kohore nuk janë kryer veprime hetimore. Pavarësisht se subjekti i kishte lënë afat OPGJ-së datën 30.7.2012 për të përfunduar veprimet hetimor, afat i cili rezulton se nuk është përmbushur, nga ana e saj nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të zbatuar afatin e përcaktuar në urdhër. Vendimin për kryerjen e ekspertimit teknik të lëndës drusore është nxjerrë nga OPGJ-ja 4 muaj pas regjistrimit të procedimit penal, ndërkohë që nuk kishte asnjë arsye që të nxirrej që në momentin e regjistrimit të procedimit penal. Pavarësisht faktit që ky vendim është nxjerrë nga OPGJ-ja, subjekti duhej të kontrollonte hetimet dhe të merrte të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e tyre në kohë. Subjekti, në kundërshtim me nenin 301 të Kodit të Procedurës Penale⁶, ka marrë vendimin për vleftësimin e sekuestros në datën 6.7.2012 (duke mos respektuar afatin prej 48 orëve), ndërkohë sendet janë sekuestruar me “procesverbal për këqyrje, marrje, sekuestrimin e mjetit dhe dokumenteve” në datën 7.5.2012. Gjithashtu, rezulton se pas më shumë se 6 muajsh nga regjistrimi i procedimit janë pyetur personat ndaj të cilëve zhvillohet hetimi.

⁶ 1. Kur vë sekuestron, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal shkakun dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonesë dhe sidoqoftë jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestronja.

2. Prokurori, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve të ardhshme, me vendim të motivuar, vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t'i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestros.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka zvarritur për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore hetimet paraprake, si dhe nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e tyre në një kohë sa më të shkurtër, duke marrë në konsideratë edhe llojin e procedimit, i cili nuk ka qenë kompleks.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar aftësi dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit nr. **/2012, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë 7 muaj e 4 ditë.

Në lidhje me këtë procedim subjekti, pas kalimit të barrë së provës, ka listuar veprimet hetimore të kryera.

Komisioni, në lidhje me këtë procedim, vlerëson se subjekti nuk i ka kryer veprimet hetimore në kohë dhe në dinamikë, pasi rezulton se për periudha të gjata kohore nuk janë kryer veprime hetimore. Vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik të lëndës drusore është nxjerrë nga OPGJ-ja 4 muaj⁷ pas regjistrimit të procedimit penal, ndërkohë që nuk kishte asnjë arsye që të nxirrej që në momentin e regjistrimit të procedimit penal. Pavarësisht fakti që ky vendim është nxjerrë nga OPGJ-ja, subjekti duhej të kontrollonte hetimet dhe të merrte të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e tyre në kohë. Pas më shumë se 5 muaj nga regjistrimi i procedimit janë pyetur personat ndaj të cilëve zhvillohet hetimi. Në datën 31.10.2012 është dorëzuar relacioni për përfundimin e hetimit, ku OPGJ-ja ka sugjeruar marrjen në përgjegjësi penale të shtetasit N. K.

Subjekti, në datën 20.12.2012, pra, gati pas 2 muajsh, ka marrë vendim për pushimin e procedimit për shkak të dhënies së amnistisë, e cila ka hyrë në fuqi në datën 28.11.2012.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka zvarritur për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore hetimet paraprake, si dhe nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e tyre në një kohë sa më të shkurtër, duke marrë në konsideratë edhe llojin e procedimit, i cili nuk ka qenë kompleks.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit nr. ***/2012, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë 7 muaj.

Në lidhje me këtë procedim subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka listuar veprimet hetimore të kryera në lidhje me këtë procedim.

Komisioni, në lidhje me këtë procedim, vlerëson se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor. Në dosje gjenden vetëm procesverbalet e deklarimeve të personit që ka dijeni për veprën penale⁸, si dhe urdhrat për thirrjen e shtetasve A.K, Gj.K dhe A.K, por nuk rezulton që të jenë pyetur.

⁷ Regjistrimi i procedimit penal është bërë në datën 16.5.2012.

⁸ Procesverbali i fundit është mbajtur në datën 22.6.2012.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka zvarritur për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore hetimet paraprake.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit nr. **/2012, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë 1-vjeçare.

Në lidhje me këtë procedim subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka listuar veprimet hetimore të kryera në lidhje me këtë procedim.

Nga verifikimi i dosjes penale rezulton se në datën 20.2.2013 është dorëzuar relacioni për përfundimin e hetimit, ku OPGJ-ja sugjeron se nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë “Universal” është konsumuar vepra penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”. Subjekti, në datën 1.2.2014, pra gati pas 1 viti, ka marrë vendim për pushimin e procedimit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka zvarritur për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore hetimet paraprake.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/*/2012, subjekti nuk ka kryer veprime hetimore për një periudhë 8 muaj e 14 ditë. Hetimet e procedimit janë zvarritur pa shkaqe të arsyeshme për një periudhë 2-vjeçare, kur çështja kishte autor që në fillim, duke vepruar në kundërshtim me nenin 323 të Kodit Penal.

Në lidhje me këtë procedim subjekti sqaron se janë kryer veprime të vazhdueshme hetimore për zbardhjen e ngjarjes, duke mbajtur parasysh edhe vështirësinë e çështjes nisur nga raportet familjare që palët në hetim kishin me njëri-tjetrin dhe shpeshherë dëshmitarët refuzonin të dëshmonin ose shfaqnin kundërtënie në deklaratimet e tyre. Gjithashtu, disa vonesa janë krijuar edhe nga kryerja dhe administrimi me vonesë i akteve të policisë shkencore.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Hetimet e procedimit janë zvarritur pa shkaqe të arsyeshme për një periudhë 2-vjeçare kur çështja kishte autor që në fillim, duke vepruar në kundërshtim me nenin 323 të Kodit Penal.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/2012 subjekti, edhe pse Prokuroria e Përgjithshme ka shfuqizuar vendimin e pushimit për hetime të paplota në datën 13.10.2013, ka vijuar sërish të mos kryejë në kohë veprimet hetimore të lëna si detyrë nga kjo prokurori, duke e zvarritur procedimin.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka deklaruar se ka kryer të gjitha veprimet hetimore, duke e dërguar çështjen në gjyq.

Bazuar në shpjegimet e subjektit, rezulton se veprimet hetimore të kryera prej saj janë pas datës 12.6.2014, datë e cila është më e vonshme se fillimi i inspektimit nga Prokuroria e Përgjithshme.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor nga data 13.10.2013, në të cilën ishte shfuqizuar vendimi i pushimit për hetime të paplota deri në datën 12.6.2014.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka vijuar sërish të mos kryejë në kohë veprimet hetimore të lëna si detyrë nga Prokuroria e Përgjithshme, duke e zvarritur procedimin.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/2012, subjekti e ka zvarritur për një periudhë 1 vit e 5 muaj.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka deklaruar se ka kryer veprime hetimore dhe nuk është e vërtetë se dosja është lënë pa veprime për një kohë të gjatë.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti, në datën 18.7.2012, ka regjistruar procedimin penal në lidhje me veprën penale të vjedhjes, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, duke regjistruar edhe emrin e personave të dyshuar. Në datën 12.7.2013 subjekti ka dërguar kërkesën për gjykim të procedimit penal nr. ***/2012. Subjekti ka zgjatur afatet e hetimit në lidhje me këtë procedim tre herë. Nga analizimi i vendimit të zgjatjeve të afateve të hetimit rezulton se dy vendimet e fundit të datës 17.1.2013 dhe datës 16.4.2013 nuk janë të argumentuar, pasi subjekti nuk ka cituar arsyet e zgjatjes së tyre. Hetimet e procedimit janë zvarritur pa shkaqe të arsyeshme për një periudhë 1-vjeçare kur çështja kishte autor që në fillim, si dhe nuk ishte kompleks pasi kishim të bënim me vjedhjen e një biçiklete, duke mos u justifikuar në këtë mënyrë koha e gjatë e hetimit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka zvarritur për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore hetimet paraprake, si dhe nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e tyre në një kohë sa më të shkurtër, duke marrë në konsideratë edhe llojin e procedimit, i cili nuk ka qenë kompleks.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/2013, subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë prej mbi 9 muaj.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti sqaroi se ka kryer veprime hetimore, duke deklaruar se në datën 27.3.2014 është kërkuar informacion për aktekspertimin vlerësues të provave materiale drejtuar Komisarariatit të Policisë Mirditë, në datën 9.5.2014 është kërkuar shoqërimi i shtetasës P. P, në datën 23.5.2014 është administruar kthimi i përgjigjes nga Komisarirati Mirditë, me shkresën nr. *** prot., për shtetasen P.P, në datën 10.6.2014 është kthyer përgjigje nga Komisarirati Mirditë, së bashku me aktekspertimin vlerësues bashkëlidhur, në datën 12.6.2014 është vendosur asgjësimi i provës materiale “kuti kartoni”, e sekuestruar, dhe në

datën 12.6.2014 është vendosur pezullimi i procedimit penal nr. ***/2013, për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, pa autor, duke qenë se nuk është bërë i mundur zbulimi i tij nga punonjësit e policisë.

Shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë procedim nuk janë bindëse. Ajo nuk ka kryer asnjë veprim hetimor në kuptim të legjislacionit procedural penal dhe ka vendosur pezullimin e procedimit në datën 12.6.2014, pas fillimi të inspektimit nga Prokuroria e Përgjithshme.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me këtë procedim penal, duke treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/2012, subjekti nuk ka kryer veprime hetimore në vijueshmëri dhe dinamikë për një periudhë 10 muaj e 9 ditë.

Në lidhje me këtë procedim subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka listuar veprimet hetimore të kryera.

Nga verifikimi i dosjes penale rezulton se subjekti nuk ka kryer veprime hetimore në vijueshmëri dhe dinamikë, pasi në datën 12.12.2012 ka regjistruar procedimin penal, ndërkohë që në datën 8.4.2013 (pas 4 muajsh) ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore. Subjekti ka lënë afat për kryerjen e veprimeve hetimore deri në datën 20.5.2013, ndërkohë që ky afat nuk rezulton të jetë respektuar. Në datën 24.7.2013 është dorëzuar relacioni për përfundimin e hetimit nga ana e OPGJ-së. Ndërkohë që subjekti vetëm në datën 18.10.2013 ka vendosur për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës shtetasin A. D. Pra, subjekti për rreth 3 muaj nuk ka kryer sërish asnjë veprim hetimor.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka zvarritur për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore hetimet paraprake.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***, datë 15.5.2014, që i përket kallëzimit penal datë 16.2.2012, subjekti për një periudhë 2 vjet e 1 muaj nuk ka kryer asnjë veprim verifikues.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka listuar veprimet hetimore të kryera prej saj, duke filluar nga data 15.5.2014. Gjithashtu, subjekti pretendoi se procedimi penal ka qenë i një prokurori tjetër, por nuk depozitoi asnjë provë për të provuar këtë pretendim.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Ajo i ka kryer veprimet hetimore pas kalimit të një periudhe më shumë se dyvjeçare.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka zvarritur për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore hetimet paraprake, duke treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/2012, subjekti nuk ka urdhëruar apo kryer ndonjë veprim hetimor për një periudhë 6 muaj e 10 ditë.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, listoi veprimet e saj hetimore, të cilat edhe nga vetë shpjegimet e saj rezultojnë se kanë diferenca të gjata kohore. Kallëzimi është bërë në datën 22.9.2012, ndërkohë që veprimi i parë hetimor është kryer në datën 16.4.2013, pra pas më shumë se 6 muajsh. Veprimi i radhës është kryer në datën 26.7.2013, pas gati 3 muajsh. Subjekti, në datën 28.1.2014, ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq pas gati 1 viti, ndërkohë që çështja nuk ishte komplekse dhe veprimet hetimore, duke qenë se kanë qenë të pakta, duhet të ishin kryer në një kohë më të shkurtër.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka zvarritur për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore hetimet paraprake, duke treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***, datë 15.5.2014, që i përket kallëzimit penal datë 10.4.2012, subjekti për një periudhë 2 vjet e 1 muaj nuk ka kryer asnjë veprim verifikues.

Për shkak të mosdhënies zgjidhje të materialeve të referuara nga policia në ngarkim të të dyshuarës A. N etj., policia ka referuar sërish materialin për këtë shtetase, duke bërë që për të njëjtin person të jenë në ndjekje dy prokurorë të ndryshëm.

Subjekti pretendon se ky procedim nuk është hetuar prej saj, por nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion provues.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/2013, subjekti nuk ka kryer veprime hetimore për një periudhë 5 muaj.

Në lidhje me këtë procedim, rezulton se si pasojë e moskryerjes së veprimeve hetimore dhe zvarritjes në hetim, duke mos ushtruar ndjekjen penale ndaj shtetasit B. P, ky person, jo vetëm që nuk është marrë në përgjegjësi penale, por është kapur sërish në flagrancë nga policia në datën 2.5.2014.

Subjekti ka listuar pas kalimit të barrës së provës veprimet hetimore të kryera prej saj, ndërkohë që një pjesë e tyre nuk janë kryer prej saj, por nga prokurori A.A në momenti që ka regjistruar procedimin e dytë për të njëjtën vepër penale në ngarkim të shtetasit B. P. Subjekti pretendon se nuk e ka zvarritur çështjen dhe ka kryer veprimet hetimore në kohë. Ajo pretendon se nuk është përgjegjësi e saj që personi nën hetim ka kryer sërish të njëjtën vepër penale.

Nga verifikimi i fashikullit të procedimit penal rezulton se subjekti, në datën 3.12.2013, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal. Në datën 10.12.2013 ka urdhëruar delegimin e veprimeve hetimore, duke lënë si afat për përfundimin e tyre datën 12.1.2014. Nga data 10.12.2013 deri më 23.7.2014 nuk është kryer asnjë veprim hetimor nga subjekti, përveçse në datën 26.5.2014 ka urdhëruar sërish delegimin e veprimeve hetimore, duke lënë si afat datën 26.6.2014. Ndërkohë, në datën 5.5.2014 prokurori A.A ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për të njëjtën vepër për shtetasin B. P.

Subjekti, vetëm në datën 23.7.2014 ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e ekspertimit teknik, pra rreth 7 muaj nga regjistrimi i procedimit, ndërkohë që ky urdhër duhej të nxirrej menjëherë.

Në lidhje me këtë procedim, rezulton se si pasojë e moskryerjes së veprimeve hetimore dhe zvarritjes në hetim, duke mos ushtruar ndjekjen penale ndaj shtetasit B. P, ky person, jo vetëm

që nuk është marrë në përgjegjësi penale, por është kapur sërish në flagrancë nga policia në datën 2.5.2014.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka zvarritur procedimin penal për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore, duke mos kryer asnjë veprim hetimor dhe duke sjellë si pasojë kryerjen sërish të veprës penale nga shtetasi B. P.

Subjekti, duke mos kryer asnjë veprim hetimor që nga momentin i regjistrimit të procedimit penal, ka treguar njohuri aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

4. Në disa raste, emri i personit që i atribuohet vepra penale është regjistruar me shumë vonesë, pavarësisht se në pjesën dërrmuese të rasteve ishte i qartë që në aktet e referuara nga policia gjyqësore.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale është në diskrecion të prokurorit, pasi lidhet me vlerësimin e provave.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale është një detyrim ligjor i parashikuar nga neni 287 i Kodit të Procedurës Penale⁹. Regjistrimi i emrit të personi lidhet edhe me respektimin e afateve të parashikuara nga neni 323 i këtij kodi dhe për shmangien e abuzimeve me zvarritjen e hetimeve në momentin që ky emër nuk regjistrohet.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti në disa raste nuk ka regjistruar në kohë emrin e personit që i atribuohet vepra penale, duke treguar njohuri, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/*/2012, subjekti nuk ka urdhëruar regjistrimin e emrit të të dyshuarit, pavarësisht se kishte të dhëna të plota për autorësinë.

Subjekti pretendon se në vitin 2012 organi i prokurorisë ka qenë i centralizuar. Drejtuesi i prokurorisë për çdo referim procedimi me të arrestuar urdhëronte menjëherë sekretarinë që të regjistronte në regjistër emrin e personit të arrestuar. Subjekti pretendon se emri i personit është regjistruar së bashku me procedimin penal.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Bazuar në aktkontrollin f. *, rezulton se subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, por nuk ka urdhëruar regjistrimin e emrit të të dyshuarit M.P, pavarësisht të dhënave të plota për autorësinë.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka regjistruar në kohë emrin e personit që i atribuohet vepra penale, duke treguar njohuri, gjykim dhe sjellje të cekëta, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit nr. ***/2012, regjistrimi i autorit të veprës penale është bërë pas 11 muajsh e 19 ditë, pa arsye ligjore.

⁹ Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti sqaroi se vetëm pas kryerjes së hetimeve rezultoi se personi që i atribuohet vepra penale nuk ishte A. C, por nëna e tij S. C.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse. Informacioni mbi referimin e veprës penale të datës 26.10.2012 ka ardhur në emër të shtetasit A. C, ndërsa pas kryerjes së veprimeve hetimore është marrë si e pandehur shtetasja S.C.

- Në rastin e procedimit nr. ***/2012, ndonëse nga policia gjyqësore është referuar se shtetasi A. B ishte personi që drejtonte automjetin në gjendje të dehur, urdhri për regjistrimin e procedimit penal nuk është bërë në emër të tij. Emri i tij është regjistruar pas gati 4 muajsh.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi se materiali procedural kishte ardhur pa autor. Pas kryerjes së aktekspertimit në datën 7.2.2013, rezultoi se ai ishte i dehur dhe subjekti në datën 19.2.2013 ka urdhëruar regjistrimin e emrit.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Bazuar në informacionin për referimin e veprës penale datë 19.11.2012, rezulton se është përpiluar procesverbali mbi verifikimin me gyp indikator (alkool test) ku shtetasi B. B rezulton pozitiv nën ndikimin e alkoolit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka regjistruar në kohë emrin e personit që i atribuohet vepra penale, duke treguar njohuri, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/2012, emri i personit që i atribuohet vepra penale është regjistruar në datën 18.10.2013, pra më shumë se 10 muaj më vonë.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi se vetëm pas kryerjes së veprimeve hetimore rezultoi se rruga që i dyshuari pretendonte se ishte e tij ishte pronë publike, duke u regjistruar edhe emri i personit që i atribuohet vepra penale.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Bazuar në informacionin për referimin e veprës penale rezulton se kemi të bëjmë me një rrugë automobilistike, e cila në asnjë rast nuk mund të jetë pronë private. Gjithashtu, në këto materiale, si dhe në dokumentacionin e depozituar, del qartë që shtetasi A. D mund të kishte kryer vepër penale, për rrjedhojë, subjekti duhej të regjistronte emrin e tij si person që i atribuohet vepra penale, në zbatim të nenin 287/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka regjistruar në kohë emrin e personit që i atribuohet vepra penale, duke treguar njohuri, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/2014, shtetasi A.N është arrestuar në flagrancë duke drejtuar automjetin pa leje drejtimi. Pavarësisht këtij fakti urdhri i regjistrimit të procedimit penal nuk është bërë në emër të tij.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi se ka qenë një harresë prej saj mosshënimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale në urdhrin e regjistrimit, por kjo nuk përbën shkelje thelbësore, pasi shtetasi A. N është arrestuar dhe në këtë rast vlen arsyetimi se materiali hetimor është regjistruar automatikisht me emër, për sa kohë kemi të bëjmë me një të arrestuar.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti nuk ka regjistruar në kohë emrin e personit që i atribuohet vepra penale, duke treguar njohuri, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/2014, shtetasi L.Z është arrestuar në flagrancë duke drejtuar mjetin pa leje drejtimi. Pavarësisht këtij fakti urdhri i regjistrimit të procedimit penal nuk është bërë në emër të tij.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi se ajo e ka regjistruar procedimin me emër të shtetasit L. Z.

Komisioni, pasi verifikoi fashikullin e procedimit penal, vlerëson se shpjegimet e subjekti janë bindëse, pasi regjistrimin e procedimit penal e ka bërë në emër të shtetasit L. Z.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/2012, emri i personit që i atribuohet vepra penale është regjistruar pas 13 muajsh e 4 ditë, pa pasur shkaqe ligjore.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, listoi veprimet hetimore të kryer prej saj. Ajo deklaroi se regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale është në diskrecion të prokurorit.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Bazuar në aktkontrollin e Prokurorisë së Përgjithshme, f. *, rezulton se shtetasi P.N kishte deklaruar se shtetasja M.P i kishte dhënë një kartëmonedhë 5,000 lekë, e cila dyshonte se ishte e falsifikuar. Subjekti duhej të regjistronte emrin e shtetasës M. P si person që i atribuohet vepra penale, në zbatim të nenit 287/1 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nuk duhej të zvarriste hetimet për një kohë të gjatë për një vepër penale që nuk ishte komplekse.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka regjistruar në kohë emrin e personit që i atribuohet vepra penale, duke treguar njohuri, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

- Në rastin e procedimit penal nr. ***/2012, subjekti e ka regjistruar, por jo emrin e autorit të veprës penale, pavarësisht se aktet ishin referuar në ngarkim të një të dyshuari konkret për të cilin ishte bërë edhe shpallja në kërkim nga policia.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se në momentin e ardhjes së materialit ishte vetëm një kallëzim penal dhe ajo ka çmuar të kryejë veprimet hetimore dhe më pas të regjistrojë emrin e personit që i atribuohet vepra penale.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse, duke marrë në konsideratë edhe faktin se aktet ishin referuar në ngarkim të një të dyshuari konkret për të cilin ishte bërë edhe shpallja në kërkim nga policia.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka regjistruar në kohë emrin e personit që i atribuohet vepra penale, duke treguar njohuri, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

5. Ndaj të dyshuarve të hetuar me masa sigurimi “arrest në burg” apo “arrest në shtëpi”, për shkak të zvarritjeve të theksuara gjatë kryerjes së veprimeve hetimore, masat e sigurimit të caktuara nga gjykata ndaj tyre kanë humbur fuqinë, duke bërë që të mbahen në burg pa

pasur masë sigurimi në fuqi. Qëndrimi i subjektit në këto raste është në kundërshtim të hapur me parashikimin e germave “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 263/1 të Kodit të Procedurës Penale, “afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit”.

i. Në rastin e procedimit nr. **/2012, masa e sigurimit “arrest në shtëpi” ka humbur fuqinë për shkak të zvarritjes së pajustificuar dhe mospërfundimit të procedimit brenda afateve ligjore. Subjekti nuk ka konstatuar shuarjen e masës së sigurimit, por është konstatuar nga drejtuesi i prokurorisë, i cili ka urdhëruar subjektin të kërkojë përpara gjykatës shuarjen e masës së sigurimit.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, pretendoi se asnjë nga shtetasit nuk ka qenë në arrest shtëpie, si dhe t’i ketë mbaruar afati i masës së sigurimit.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Prokuroria e Përgjithshme ka konstatuar në aktin e kontrollit se vendimi nr. ***, datë 7.11.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, që ka zëvendësuar masën e sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest në shtëpi” në ngarkim të shtetasit A. Ll, sipas parashikimit të neneve 263 dhe 267 të Kodit të Procedurës Penale ka humbur fuqinë. Për këtë arsye, dhe me qëllim kryerjen e hetimeve paraprake në përputhje me kërkesat e ligjit procedural penal, si dhe respektimin e të drejtave procedurale, ishte e domosdoshme të konstatohej shuarja e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”. Në datën 18.2.2014 drejtuesi i prokurorisë ka urdhëruar subjektin për të kryer brenda një afati 1-mujor të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, duke i vënë në dispozicion dy oficerë të policisë gjyqësore, si dhe për t’i kërkuar gjykatës shuarjen dhe caktimin e masës së sigurimit. Në datën 15.5.2014 drejtuesi i prokurorisë, duke qenë se hetimet po zvarriteshin, ka vendosur zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se masa e sigurimit ka humbur fuqinë për shkak të zvarritjes së pajustificuar dhe mospërfundimit të procedimit brenda afateve ligjore. Qëndrimi i subjektit është në kundërshtim me parashikimin e pikës 1 të nenit 263/1 të Kodit të Procedurës Penale, “afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit”, duke treguar njohuri, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale. Gjithashtu, subjekti nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve.

ii. Në rastin e procedimit nr. ***/2012, i pandehuri kishte më shumë se 6 muaj në paraburgim. Veprat penale për të cilat ishte nën hetim i pandehuri parashikojnë dënim në maksimumin deri në 10 vjet, bazuar në kërkesat e nenit 263/1-b të Kodit të Procedurës Penale masa e sigurimit kishte humbur fuqinë.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti sqaroi se në asnjë rast i dyshuari nuk ka qëndruar në burg 6 muaj tej afatit, por brenda afatit 6-mujor të hetimit nuk janë kryer të gjitha veprimet dhe çështja nuk është dërguar në gjyq, duke kërkuar vetë zëvendësimin e masës së sigurimit dhe caktimin e një mase tjetër “detyrim për t’u paraqitur para oficerit të policisë gjyqësore”.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti, vetëm pasi është urdhëruar nga drejtuesi i prokurorisë, ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit, pasi, bazuar në aktkontrollin e Prokurorisë së Përgjithshme, e ka dorëzuar dosjen për kontroll, duke vendosur në datën 20.4.2013 dërgimin e çështjes në gjyq, vendimi i cili është shfuqizuar nga drejtuesi i prokurorisë, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve të nevojshme për

heqjen e gjendjes së paligjshme rreth masës së sigurimit, si dhe kryerjen e disa veprimeve hetimore.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se qëndrimi i subjektit është në kundërshtim me parashikimin e pikës 1 të nenit 263/1 të Kodit të Procedurës Penale, “afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit”, duke treguar njohuri, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale. Gjithashtu, subjekti nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve.

6. Vendimet e mosfillimit dhe vendimet e pushimit të procedimeve penale, në raste të përsëritura, nuk u janë njoftuar menjëherë personave të interesuar, duke vepruar në mënyrë të përsëritur në kundërshtim me parashikimet e neneve 291 dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale. Një pjesë e këtyre vendimeve janë mbajtur në zyrën e subjektit, duke mos iu njoftuar palëve.

Subjekti, pas kalimit të barrës, sqaroi se në rastin e mosfillimeve dhe procedimeve penale kur prokurori dërgon shkresën në sekretari për njoftim konstatohet me shumë si një veprim administrativ, pasi është sekretaria që si rregull dërgon njoftimin fizikisht dhe si rregull duhet të administrojë kopjen e njoftimit të vendimit ose të mosfillimit në fashikull për të bërë të vërtetueshëm faktin që subjekti është njoftuar. Në praktikën e përditshme, shkresat përcjellëse dërgohen në postë nga sekretaria dhe nuk ndiqen më përtej nëse kanë shkuar ose jo. Në lidhje me dosjet e përfunduara në zyrë pa dorëzuar, subjekti sqaron se duke qenë se kanë qenë muajt e parë të fillimit të punës, pasi dërgonte shkresën përcjellëse me vendimin për njoftimin e palëve, priste që të vinte nga sekretaria kopje e komunikatës së njoftimit të palëve, por duke qenë se kjo procedurë zgjaste në kohë, ndonjëherë mund t'i jenë gjetur dosje të përfunduara në zyrë. Kjo shkelje administrative, sipas saj, është bërë pa ndonjë qëllim, por në fillimet e punës si prokurore nga moskuptimi si duhet i mënyrës së punës dhe mospasjes së eksperiencës administrative në menaxhimin e shkresave siç duhet.

Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale në lidhje me njoftimin e vendimeve. Pavarësisht faktit që njoftimi kryhet nga sekretaria është detyrë e prokurorit të mbikëqyrë dërgimin pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit. Në rastin kur këto vendime nuk i janë njoftuar menjëherë palëve kanë sjellë si pasojë cenimin e të drejtës së tyre për të ushtruar ankim, parashikuar nga nenet 291 dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale. Në disa raste këto vendime nuk rezultojnë të jenë zbritur as në protokollin e prokurorisë, por janë mbajtur në zyrën e subjektit, duke mos iu njoftuar palëve.

Në përfundim Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar njohuri gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale. Gjithashtu, subjekti nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve, si dhe nuk ka aftësi për të administruar dosjen të cilat konsiderohen si mangësi profesionale.

7. Gjatë përfaqësimit të organit të akuzës në gjyq, gjatë periudhës objekt kontrolli, subjekti nuk ka marrë pjesë në gjykim, pa shkaqe të justifikuara, për 77 seanca gjyqësore, duke bërë që datat e gjykimit të caktuara nga gjykata të shtyhen në data të tjera për mosparaqitje të saj.

i. Në rastin e procedimit penal nr. ***/2014, subjekti në dy seanca gjyqësore nuk ka marrë pjesë në gjykim pa shkaqe të përligjura.

ii. Gjatë vitit 2012, subjekti nuk ka marrë pjesë në gjykim pa arsye në 17 seanca.

iii. Gjatë vitit 2013, subjekti nuk ka marrë pjesë në gjykim pa arsye në 29 seanca. Në një gjykim ka kryer 6 mungesa, ndërsa në dy gjykime nga 5 mungesa në secilin gjykim.

iv. Gjatë vitit 2014, subjekti nuk ka marrë pjesë në gjykim pa arsye në 31 seanca. Në një gjykim ka kryer 5 mungesa, ndërsa në dy gjykime nga 4 mungesa në secilin gjykim.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se në shumë raste, duke qenë se gjyqet shtyheshin me minuta ose me orë, ndodhte që ndërkohë që prokurori ishte në një seancë gjyqësore (të filluar me vonesë) gjyqtari i seancës së radhës shtynte seancën për mosparaqitje. Gjithashtu duhet të mbahet parasysh largësia që ndodhet prokuroria nga gjykata (rreth 15 minuta me këmbë) dhe mungesa e transportit që e bënin në kushte të vështira atmosferike vajtjen në orare në gjykatë. Gjithashtu, fakti që shpeshherë është e nevojshme shkëputja për të kryer veprimet në prokurori dhe kthimi përsëri në gjykatë si rezultat i orareve të ndryshme me shumë hapësirë të ndërmjetme, kur zhvilloheshin seancat gjyqësore. Duhet të mbahet parasysh edhe mungesa e sallave të gjykimit që shtynin seancat gjyqësore dhe krijonin mbivendosjen e orareve.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova. Është detyrë e prokurorit që të marrë pjesë në seanca gjyqësore dhe vetëm në rastet e pamundësisë për shkaqe shëndetësore ose shkaqe të tjera të arsyeshme të kërkojë shtyrjen e seancës ose të mos paraqitet në seancë. Në rastin konkret, nuk rezulton që nga subjekti të jetë provuar që mungesa e saj në seanca gjyqësore të ketë ardhur për shkaqe shëndetësore ose ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm. Largësia nga gjykata apo kushtet atmosferike nuk përbëjnë shkaqe të arsyeshme për të mos u paraqitur.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka marrë pjesë në gjykim, pa shkaqe të justifikuara, për 77 seanca gjyqësore, duke bërë që datat e gjykimit të caktuara nga gjykata të shtyhen në data të tjera për mosparaqitje të saj, duke treguar se ajo nuk është efektive, si dhe nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve, të cilat konsiderohen si mangësi profesionale.

8. Subjekti ka mbajtur në zyrën e saj një sërë fashikujsh hetimorë të përfunduar pa i dërguar për kontroll te drejtuesi i prokurorisë dhe pa i hequr nga regjistri, pavarësisht përfundimit të tyre, duke vepruar në kundërshtim me rregullin e arkivës për arkivimin e fashikujve të ndryshëm hetimorë, si fashikuj mosfillimi procedimi penal, procedimesh penale të pushuara dhe të çështjeve të dërguara për gjykim, si dhe në kundërshtim të plotë me praktikën e konsoliduar në rang prokurorie.

i. Fashikulli i procedimit penal nr. ***/2012 është mbajtur në zyrë nga subjekti deri në datën 6.6.2014, për një periudhë prej 1 viti, 8 muaj e 26 ditë. Janë mbajtur në zyrë pa u dorëzuar për arkivim për një periudhë më shumë se 1 vit e 6 muaj materiale kallëzuese (nr. ***/2012, nr. ***/2012 dhe nr. ***/2012), të cilat janë dërguar për kompetencë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

ii. Fashikulli i procedimit penal nr. **/2013 është mbajtur në zyrë nga subjekti deri në datën 2.6.2014, për një periudhë prej 5 muajsh e 27 ditë.

iii. Fashikulli i procedimit penal nr. **/2013 është mbajtur në zyrë nga subjekti deri në datën 6.6.2014, për një periudhë prej 5 muajsh e 31 ditë.

iv. Fashikulli i procedimit penal nr. **/2013 është mbajtur në zyrë nga subjekti deri në datën 6.6.2014, për një periudhë 2-mujore.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi se nuk ka një urdhër ose rregullore për administrimin e dosjeve të mbaruara me vendim gjykate. Si rregull depozitohen te zyra e prokurorit të rrethit, i cili i siglon dhe më pas administrohen në arkivë. Por për këtë fakt nuk ka afate që normojnë se kur i ka dorëzuar prokurori i çështjes te prokurori i rrethit dhe kur i ka dorëzuar prokurori i rrethit në arkivë. Kjo është një lloj procedure magazinimi/depozitimi dosjesh, që si rregull është veprim administrativ i brendshëm dhe nuk ka asnjë lidhje me vendimmarrjen dhe veprimtarinë e prokurorit të çështjes.

Komisioni vlerëson se mbajtja në zyrë nga subjekti të një sërë fashikujsh hetimorë të përfunduar pa i dërguar për kontroll te drejtuesi i prokurorisë dhe pa i hequr nga regjistri, pavarësisht përfundimit të tyre, tregon se subjekti nuk ka aftësi për të administruar dosjen, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

v. Procedimi penal nr. **/2012 është paraqitur në sekretari në datën 6.6.2014. Subjekti ka përpiluar vetëm vendimin e pezullimit, por nuk ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal. Ajo nuk ka kryer asnjë veprim hetimor dhe nuk e ka dorëzuar për një periudhë 1 vit e 9 muaj. Ky procedim është emërtuar me nr. **, ndërsa aktet flasin për pezullimin e procedimit penal nr. ***/2012.

Në lidhje me këtë procedim, pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se në datën 17.7.2012, mbi bazën e materialit kallëzues nr. ***/2012, të referuar nga Komisariati i Policisë Lezhë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, të vitit 2012. Ajo ka ngarkuar oficerin e policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Lezhë të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për identifikimin e personave të paraqitur për video regjistrim, duke përdorur metodat e nevojshme kriminalistike, por megjithatë nuk është arritur të identifikohen personat e dyshuar. Në këto kushte, në datën 5.9.2012 ka disponuar për pezullimin e hetimeve të procedimit penal. Vendimi i pezullimit ka karakter të përkohshëm dhe nuk ka ndonjë efekt në mbarimin e afatit të parashkrimit të ndjekjes penale. Si praktikë pune në prokurori, procedimet penale të pezulluar dërgohen në Komisariatin e Policisë Lezhë me asnjë qëllim tjetër përveçse duke qënë se oficerët e policisë se komisarariatit janë më afër terrenit dhe informacioneve operative të cilat mundësojnë marrjen më lehtë dhe më shpejt të provave ose fakteve të reja që mund të bëjnë të mundur rifillimin e hetimeve të pezulluara, ose e thënë ndryshe, për komoditet më të madh pune për prokurorin dhe oficerët e prokurorisë, të cilët janë më “larg” informacioneve dhe zhvillimeve në terren. Në lidhje me pretendimin se në dosje nuk është urdhri i regjistrimit, kallëzimi penal nr. *** ka marrë numër procedimi penal, dhe përkatësisht nr. ***, të vitit 2012. Këtë fakt e ka pasur të qartë edhe grupi i kontrollit, i cili pohon se është procedim, por nuk është urdhri i regjistrimit në dosje. Fakti që kallëzimi ka marrë një numër procedimi identifikohet nga vula që ka në material hetimor të vendosur me numër dhe datë nga sekretaria e prokurorisë. Fakti i përmendur që procedimi ka nr. ***/2012

dhe te titulli është *** (numri i këtij materiali si kallëzim), duket që është gabim material dhe nuk është e përshtatshme të konstatohet si shkelje, pasi nuk është në fakt shkelje, duke qenë se kuptohet tërësisht në të gjithë trupin e aktit që kemi të bëjmë me procedimin nr. ***/2012.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Procedimi penal nr. ***/2012 është paraqitur në sekretari në datën 6.6.2014. Subjekti ka përpiluar vetëm vendimin e pezullimit, por nuk ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal. Ajo nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, si dhe nuk e ka dorëzuar për një periudhë 1 vit e 9 muaj.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar sjellje të cekëta, ka shfaqur mangësi në administrimin e dosjes, si dhe nuk ka kryer në mënyrë të efektshme procedurat e tjera të sistemit të prokurorisë, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

vi. Subjekti ka mbajtur në zyrë, pa i dorëzuar në sekretari, disa fashikuj të procedimeve penale, ndonëse vendimet ishin marrë me kohë. Dorëzimi i tyre është bërë në datën 6.6.2014.

- Procedimi penal nr. ***/2012 është mbajtur për një periudhë 1 vit e 7 muaj.
- Procedimi penal nr. ***/2012 është mbajtur për një periudhë 1 vit e 7 muaj.
- Procedimi penal nr. **/2013 është mbajtur për një periudhë 6 muaj.
- Procedimi penal nr. **/2013 është mbajtur për një periudhë 6 muaj.
- Procedimi penal nr. **/2013 është mbajtur për një periudhë 6 muaj.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se nuk ka një urdhër ose rregullore për administrimin e dosjeve të mbaruara me vendim gjykate. Si rregull, depozitohen në zyrën e prokurorit të rrethit, i cili i siglon dhe më pas administrohen në arkivë. Por për këtë fakt nuk ka afate që normojnë se kur i ka dorëzuar prokurori i çështje tek prokurori i rrethit dhe kur i ka dorëzuar prokurori i rrethit në arkivë. Kjo është një lloj procedure magazinimi/depozitimi dosjesh, që si rregull është veprim administrativ i brendshëm dhe nuk ka asnjë lidhje me vendimmarrjen dhe veprimtarinë e prokurorit.

Komisioni vlerëson se mbajtja në zyrë nga subjekti të një sërë fashikujsh hetimorë të procedimeve penale, ndonëse vendimet ishin marrë me kohë, tregon se ajo nuk ka aftësi për të administruar dosjen, si dhe nuk është efektive, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

9. Në rastin e procedimit nr. ***/*/2012, subjekti ka vendosur lirimin e menjëhershëm të të ndaluarit, pa kërkuar në gjykatë vlefësimin e paligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

Qëndrimi i subjektit për lirimin e menjëhershëm të të arrestuarit nuk është i mbështetur në ligj, pasi në rastin konkret, duke parë rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit, duhej të kërkohej caktimi i masës së sigurimit.

Procedimi është mbajtur nën hetim deri në datën 6.6.2014, kur subjekti ka vendosur të dërgojë çështjen për gjykim në mungesë të të pandehurit, pa masë sigurimi në ngarkim të tij. Hetimet e procedimit janë zvarritur pa shkaqe të arsyeshme për një periudhë 2-vjeçare kur çështja kishte autor që në fillim, duke vepruar në kundërshtim me nenin 323 të Kodit Penal.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi se është vlerësuar lrimi i menjëhershëm i të ndaluarit me iniciativë të policisë gjyqësore, duke qenë se ndalimi nuk përmbushte kushtet që parashikon ligji për t'u ekzekutuar si veprim procedural. Neni 253 i Kodit të Procedurës Penale

(i kohës) parashikon se: “[...] Kur ka shkaqe të bazuara për të menduar rrezikun e ikjes, prokurori urdhëron ndalimin e të dyshuarit për një krim. Policia gjyqësore kryen ndalimin me iniciativë të vet, kur është e pamundur për shkak të gjendjes së ngutshme që të pritët urdhri i prokurorit”. Lirimi është vlerësuar nën dritën e kësaj dispozite me karakter urdhërues, e cila sanksionon se është vetëm prokurori që duhet të nxjerrë urdhrin e ndalimi kur ekziston rreziku eminent i ikjes së të pandehur dhe, për pasojë, kapja e tij do të jetë e vështirë ose e pamundur (p.sh. ka të dhëna se po përgatit largimin jashtë vendit). Në rastin konkret nuk është justifikuar arsye e ngutshme, duke qenë se ngjarja ka ndodhur në datën 19.6.2021 dhe fakti është referuar në datën 21.6.2012, kur prokurori ka pasur të gjithë mundësinë të ndërhynte, nëse e vlerësonte me urdhër ndalimi.

Në lidhje me masën e sigurimit “arrest në burg”, siç është konstatuar nga raporti i kontrollit, subjekti sqaron se ai është një çmim i tyre dhe jo domosdoshmërisht është shkelje në kuptimin e cenimit të ndonjë dispozite penale. Caktimi i masës së sigurimit dhe lloji i saj është në diskrecion të prokurorit të çështjes, i cili vlerëson kushtet, nevojën dhe kriteret, si dhe bën kërkesën në gjykatë nëse e konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme një lloj mase sigurimi të caktuar.

Në lidhje me moscaktimin e një mase sigurimi, subjekti është bazuar në ligjin dhe në dispozitën e kohës së kryerjes së veprës që parashikonte për armbajtjen pa leje dënimin me gjobë dhe nuk paraqiste nga legjislatori rrezikshmërinë e sotshme, faktin që vepra tjetër penale për të cilën dyshohej ishte për kanosje, e cila përbënte dhe përbën kundërvajtje penale. Gjithashtu, në rastin konkret është mbajtur parasysh se shtetasi i dyshuar ishte në moshë të re dhe sapo kishte kaluar pragun e miturisë (sapo kishte mbushur 18 vjeç); xhaxhai i tij disa herë kishte ushtruar dhunë tek ai dhe i vëllai i mitur i moshës 13 vjeç; fakti që kallëzuesi nuk kishte pësuar asnjë dëmtim nga vepra penale; fakti që edhe vetë neni i kohës (përpara ndryshimeve të Kodit Penal të vitit 2013 për armbajtjen) parashikonte si alternativë dënimin me gjobë për këtë veprë penale (dhe në mjaft raste edhe gjykata aplikonte një lloj të tillë dënimi në raste të ngjashme).

Subjekti, më tej, ka listuar veprimet që ka kryer, duke pretenduar se nuk e ka zvarritur hetimin.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse, për sa i përket lirim të menjëhershëm të të arrestuarit dhe moscaktimit të masës së sigurimit, pasi referuar shpjegimeve të saj Komisioni nuk mund të përfshihet në themelin e çështjes dhe bindjen e saj të brendshme, për sa kohë nuk kemi të bëjmë me shkelje procedurale. Për sa i përket hetimeve, ato janë zvarritur pa shkaqe të arsyeshme për një periudhë 2-vjeçare kur çështja kishte autor që në fillim.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

10. Në rastin e procedimit nr. **/2012, subjekti, për një periudhë më shumë se 2-vjeçare, ka zgjatur afatet e hetimit, por nuk ka kryer asnjë veprim hetimor.

Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të dyshuarin G. D, i cili sipas dinamikës së ngjarjes kishte hedhur një granatë në drejtim të njerëzve të familjes Ll.

Subjekti nuk ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit për shtetasin G. D, pavarësisht faktit se në ngarkim të tij ishte regjistruar procedimi penal për veprat penale të parashikuara nga neni

79/dh-22 i Kodit Penal dhe neni 278/2, duke vepruar në kundërshtim me nenet 228-230 të Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti, në kundërshtim me kërkesat e neneve 24, 30/2 dhe 304 të Kodit të Procedurës Penale nuk ka përpiluar urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore që nga regjistrimi i procedimit penal, duke kaluar një periudhë kohore prej më shumë se 1 viti e 4 muaj.

Subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, duke neglizhuar faktin e përdorimit në këtë ngjarje të një arme tjetër, veç atyre për të cilat ishte regjistruar procedimi penal. Fakti se gëzhojat e fiksuara në vendngjarje kanë rezultuar të qitura nga dy armë të ndryshme, detyron prokuroren të orientojë policinë gjyqësore apo të kryente vetë hetime edhe për një person të tretë.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se për shtetasin A.Ll është bërë arresti në flagrancë nga oficerët e policisë gjyqësore, për veprat penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municionit luftarak” dhe “kanosje”, parashikuar nga nenet 278/2 dhe 84 të Kodit Penal dhe është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa shtetasi G.D është larguar që në momentet e para të ngjarjes dhe nuk është bërë e mundur kapja e tij nga oficerët e policisë gjyqësore. Për këtë arsye Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë i është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, në mungesë, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale ndaj shtetasit G.D, kërkesë që është pranuar nga gjykata. Veprimet hetimore janë kryer në vazhdim nga oficerët e krimeve kundër personit në Komisaratin e Policisë Mirditë, të cilëve i është deleguar nga subjekti dosja penale për mbledhje provash dhe aktesh. Veprimet hetimore të policisë gjyqësore mund t’i delegohen verbalisht ose me shkrim dhe fakti që i ka deleguar verbalisht nuk përbën shkelje (urdhri i delegimit me shkrim saktëson dhe pasqyron më objektivisht detyrat e lëna dhe afatin për t’u kryer).

Në lidhje me faktin që duhet të hetohet për personin tjetër, që eventualisht mund të ketë qëlluar në vendin e ngjarjes (pasi shtetasi A. Ll ka deklaruar se ka gjuajtur me automatik) janë kryer veprime nga prokuroria, duke deleguar dosjen në komisaratin për veprimeve të tjera zbuluese dhe pasi për autorin e mundshëm nuk rezultoi asnjë fakt i rëndësishëm për identitetin e tij, ajo ka vendosur pezullimin e procedimit dhe ia ka rideleguar përsëri oficerëve për veprime operative të terrenit dhe informacionit në zbulimin e personit/ave që mund të kenë qëlluar në vendin e ngjarjes.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti, për një periudhë më shumë se 2-vjeçare ka zgjatur afatet e hetimit, por pa kryer asnjë veprim hetimor.

Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të dyshuarin G. D, i cili sipas dinamikës së ngjarjes kishte hedhur një granatë në drejtim të njerëzve të familjes Ll. Subjekti, në kundërshtim me kërkesat e neneve 24, 30/2 dhe 304 të Kodit të Procedurës Penale nuk ka përpiluar urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore që nga regjistrimi i procedimit penal, duke kaluar një periudhë kohore prej më shumë se 1 viti e 4 muaj. Subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, duke neglizhuar faktin e përdorimit në këtë ngjarje të një arme tjetër veç atyre për të cilat ishte regjistruar procedimi penal. Fakti se gëzhojat e fiksuara në vendngjarje kanë rezultuar të qitura nga dy armë të ndryshme detyron

prokuroren të orientojë policinë gjyqësore apo të kryente vetë hetime edhe për një person të tretë.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

11. Në rastin e procedimit nr. **/2012, subjekti nuk ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit për të dyshuarin, duke vepruar në kundërshtim me nenet 228-230 të Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti, në datën 8.4.2013, pas rreth 7 muajsh, është urdhëruar nga drejtuesi i prokurorisë për të regjistruar emrin e autorit të veprës penale dhe për të kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, në mungesë.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se procedimi penal ndaj shtetasit N. P është regjistruar që në momentin e ardhjes së materialit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë për veprat penale “kanosje” dhe “prodhim pa leje dhe mbajtje e armëve dhe municionit luftarak”, parashikuar nga nenet 84 dhe 278/2. Ndaj tij është kërkuar dhe është vendosur masa e sigurisë në burg, me vendimin nr. ***, datë 16.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe është deklaruar ikja e tij me vendimin nr. **, datë 27.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Sa më sipër, i pandehuri është dërguar për gjykim me masën e sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Bazuar dhe në vetë shpjegimet e saj rezulton se subjekti nuk ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit për shtetasin N. P që në momentin e regjistrimit të procedimit penal. Subjekti deklaron se masa e sigurimit është caktuar në datën 16.5.2013, e cila përkon me urdhërimin e drejtuesit të përgjithshëm për të kërkuar caktimin e masës së sigurimit.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti nuk ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit për të dyshuarin, duke vepruar në kundërshtim me nenet 228 - 230 të Kodit të Procedurës Penale, duke treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

12. Në rastin e procedimit nr. ***/2012, rezulton se të pandehurit i janë cenuar të drejtat, si vijon:

i. Procesverbali i deklarimit nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet është mbajtur në kundërshtim me nenet 49, 296 dhe 99 të Kodit të Procedurës Penale. Deklaruesi ka vënë në përfundim të deklarimit vetëm nënshkrimin e tij dhe në fund të procesverbalit është shënuar se “nuk din të shkruajë dhe as të lexojë por din me vënë firmën”. Ky akt është deklaruar absolutisht i pavlefshëm nga drejtuesi i prokurorisë, bazuar në kërkesat e nenit 128/1-c të Kodit të Procedurës Penale.

ii. Vendimet për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor nuk i janë njoftuar rregullisht të pandehurit.

iii. Të pandehurit, në datën 20.4.2013, kur është pyetur, i është caktuar avokat mbrojtës kryesisht I.J, i cili ka qenë në konflikt interesi, pasi ka pasur lidhje familjare me OPGJ-në e çështjes P.J. Ndërkohë, në datën 16.4.2013, me vendim, si avokat është caktuar M. Ll. Hetimet në lidhje me këtë procedim kanë vijuar për një periudhë prej 8 muajsh e 19 ditë, pa shkaqe ligjore.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se të pandehurit nuk i është cenuar asnjë e drejtë. Në lidhje me firmën e të dyshuarit M. M në aktet procedurale jo të garantuara (si akti mjeko-ligjor) dhe të garantuara, ky shtetas ka nënshkruar emër, mbiemër dhe ka firmosur, dhe ku anash oficerja e policisë gjyqësore ka evidentuar me shkrimin e saj se nuk di të shkruajë, por di të nënshkruajë, nuk ka asnjë pavlefshmëri në kuptimin formal ligjor dhe asnjë cenim të të drejtave të të pandehurit, siç pretendohet në aktin e kontrollit. Personit nën hetim i është/janë lexuar akti/et rregullisht në prani të avokatit të zgjedhur dhe të pranuar prej tij. Personi në fjalë nuk di të shkruajë rregullisht (fjali), por shkruan normalisht pa pengesë emrin, mbiemrin dhe hedh nënshkrimin e tij. Pra, në rastin konkret atij i është lexuar përmbajtja e aktit në prani të avokatit dhe ka firmosur vetë, duke nënshkruar në përputhje me ligjin. Fakti që nuk di të shkruajë nënkupton se ai nuk shkruan formate të gjata drejtshkrimore dhe jo emër, mbiemër dhe firmë, pasi ka qenë vetë i dyshuari që pasi i është bërë me dije rregullisht përmbajtja e aktit dhe ka pranuar në prezencë të avokatit të tij që është njohur dhe ka kuptuar rregullisht përmbajtjen, e ka nënshkruar vetë personalisht aktin sipas rregullave procedurale (emër, mbiemër, firmë). Gjithashtu, aktet e mësipërme i janë komunikuar jo vetëm të dyshuarit, por edhe avokatit të tij, i cili ka qenë prezent kur i dyshuari ka nënshkruar vetë rregullisht, duke qenë se në procesverbalet përkatëse jo vetëm ka nënshkruar vetë avokati, por ka pranuar rregullisht se ka marrë dijeni për përmbajtjen e aktit dhe se klienti i tij ka nënshkruar personalisht. Kur personi nuk është në gjendje të nënshkruajë, nëpunësi para të cilit paraqitet akti i shkruar ose që regjistron aktin e bërë verbalisht sigurohet për identitetin e personit dhe e pasqyron këtë fakt në fund të aktit, në praninë e një personi të tretë. Në rastin konkret, i dyshuari është në gjendje të nënshkruajë dhe megjithëse nënshkruan vetë është i pranishëm edhe avokati i zgjedhur prej tij, që sigurohet për aktin dhe pasojat e tij. Ai s' di të relatojë fjalë të gjata, por emër, mbiemër, firmë e shkruan lehtësisht.

Në datën 4.3.2012 është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor të shtetasit M. M në konfliktin që kishte pasur me punonjësin e policisë A.B, i cili e ka firmosur vetë rregullisht dhe avokati i zgjedhur prej tij M.Ll. Ky i dyshuar është pyetur më 27.5.2013 si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet, në datën 31.5.2013 i është njoftuar akuza dhe në datën 31.5.2013 është pyetur, me cilësinë e të pandehurit, dhe në të treja rastet në prani të avokatit të tij M.Ll. Konstatimi se në datën 16.4.2013 është caktuar av. M.Ll dhe në datën 20.4.2013 është pyetur nga av. I.J, është i pabazuar në akte dhe në logjikë se nuk ka asnjë arsye që të caktohet një avokat dhe të pyetet nga një tjetër, aq më tepër që në të gjitha aktet del rregullisht se është pyetur në prani të av. M. Ll dhe çdo veprim tjetër procedural është bërë në prani të tij (p.sh. akti mjeko-ligjor i datës 4.3.2012). Pra, pretendimet nuk qëndrojnë.

Në lidhje me konkluzionet e parashtruara në procesverbalin e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme se për të pandehurin M. M është caktuar av. I.J që ka konflikt interesi me oficeren e dosjes P.J, sqarohet se ky konkludim nuk është i bazuar në asnjë nga aktet

garantuese të ndërmarra nga prokurori gjatë hetimit të të dyshuarit dhe as në në fashikullin e procedimit penal. Që në fillim të procedimit penal i dyshuari M. M, me dëshirën e tij, është asistuar nga av. M.Ll. Kjo është pasqyruar që në vendimin për caktimin e ekspertimit mjekoligjor datë 4.3.2012, të shtetasit M. M, ku ka nënshkruar vetë i dyshuari dhe av. M.Ll. Gjithashtu, edhe pyetja e të dyshuarit M.M si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet për veprën penale “kundërshtim i punonjësit të rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal, në procesverbalin e muajit mars të vitit 2012 është bërë në prani të avokatit të deklaruar prej tij M.Ll. Gjithashtu, edhe në pyetjen e të dyshuarit M. M në lidhje me veprat penale “vjedhje” dhe “mosbindje ndaj urdhrin të punonjësit të rendit publik”, parashikuar nga nenet 134.1 dhe 242 të Kodit Penal, në datën 27.5.2013 (procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet) ka asistuar av. M.Ll. Ky avokat ka nënshkruar edhe në vendimin për njoftimin e akuzës, datë 31.5.2013, ndaj të pandehurit M.M, si dhe pyetjen e të pandehurit po në këtë datë. Gjithashtu, avokati ka nënshkruar edhe kërkesën për gjykim. Pra, në të gjithë historinë procedurale të hetimit të procedimit penal nr. ***/2012, në ngarkim të të pandehurit M. M, në asnjë rast nuk vërtetohet që të këtë marrë pjesë gjatë këtij procedimi av. I.J, i caktuar, duke qenë se prokurori nuk kishte diskrecion dhe nevojshmëri në caktimin e një avokati kryesisht, duke qenë se i dyshuari M.M ka qenë i asistuar gjithmonë nga avokati i zgjedhur prej tij M.Ll. Në këtë kontekst, pretendimet e gjetura në aktin e kontrollit për konflikt interesi ndërmjet av. I.J dhe shtetas P. J (lidhje gjinie) nuk janë të bazuara, pasi ky fakt nuk gjen mbështetje dhe pasqyrim në asnjë nga aktet procedurale. Në asnjë moment nuk pasqyrohet nënshkrimi i një avokati të ndryshëm nga ai i pranuar nga vetë i dyshuari që ka qenë që në veprimet e para të av. M. Ll.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se procesverbali i deklarimit nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet është deklaruar absolutisht i pavlefshëm nga drejtuesi i prokurorisë, bazuar në kërkesat e nenit 128/1-c të Kodit të Procedurës Penale. Hetimet në lidhje me këtë procedim kanë vijuar për një periudhë 8 muaj e 19 ditë, pa shkaqe ligjore.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

13. Në zyrën e subjektit është gjetur një procedim penal me nr. **/2013 që i përkiste një subjekti tjetër.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se në dorëzimin e dosjeve për kontroll ka kërkuar që oficerët të sillnin dosjet e saj që kishin nën hetim, me qëllim që t'i nënshtroheshin kontrollit të detyruar. Në një nga dosjet e deleguara oficerit dhe të sjella te ajo, gabimisht ishte edhe një dosje hetimore e një subjekti tjetër që ia kishte dërguar po të njëjtit oficer, por që u mor nga ky i fundit dhe nuk u konstatua asnjë anomali.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse.

24.3. Me urdhrin nr. 272, datë 31.10.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjektit të rivlerësimit i është dhënë masa disiplinore “vërejtje” për shkeljet e konstatuara.

Procedimi disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar mbi bazën e relacionit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme pas verifikimit të shkeljeve dhe të metave të konstatuar nga inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me veprimtarinë e subjektit. Pas verifikimit, nga materiali i kësaj drejtorie ka rezultuar se nga ana e subjektit të rivlerësimit janë lejuar zvarritje sistematike të pajustificuara të hetimeve për një numër të konsiderueshëm procedimesh penale, si vijon:

- i. Në 6 procedime penale, megjithëse nga oficerët e policisë gjyqësore hetimet janë konsideruar të përfunduara dhe janë përpiluar relacionet përfundimtare mbi mënyrën e përfundimit të procedimit penal, prokurorja, pa asnjë shkak ligjor dhe pa kryer asnjë veprim hetimor, i ka mbajtur dosjet në dorë për disa muaj dhe më pas ka përpiluar vendimet e pushimit të procedimeve penale.
- ii. Në 6 procedime penale të tjera janë konstatuar zvarritje sistematike të hetimeve, pasi për periudha kohore të gjata rezulton se nuk janë kryer veprime hetimore.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi për secilin procedim veprimet hetimore të kryera prej saj.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, fashikujt e procedimeve penale, si dhe raportin e kontrollit të drejtorisë së inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë, vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse.

Nga analizimi i 12 dosjeve hetimore rezulton se nga ana e subjektit nuk ka vijueshmëri dhe rregullueshmëri të veprimeve hetimore për periudha të gjata kohore, rezulton se nuk janë kryer veprime hetimore, si dhe megjithëse nga oficerët e policisë gjyqësore hetimet janë konsideruar të përfunduara dhe janë përpiluar relacionet përfundimtare mbi mënyrën e përfundimit të procedimit penal, subjekti, pa asnjë shkak ligjor dhe pa kryer asnjë veprim hetimor, ka vonuar për disa muaj vendimet e pushimit të procedimeve penale.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

24.4. Në mënyrë të përsëritur, nga dy inspektime të ndryshme subjektit i janë konstatuar zvarritje sistematike të hetimeve, pasi për periudha kohore të gjata rezulton se nuk janë kryer veprime hetimore, si dhe megjithëse nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore hetimet janë konsideruar të përfunduara dhe janë përpiluar relacionet përfundimtare mbi mënyrën e përfundimit të procedimit penal, subjekti, pa asnjë shkak ligjor dhe pa kryer asnjë veprim hetimor, i ka mbajtur dosjet në dorë për disa muaj dhe më pas ka përpiluar vendimet e pushimit të procedimeve penale.

24.5. Në lidhje me dy masat disiplinore të caktuara nga Prokurori i Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se përbëjnë gjë të gjykuar dhe nuk mund të shërbejnë si bazë faktike për të caktuar një masë tjetër disiplinore.

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioni vlerëson se nuk jemi përpara gjësë së gjykuar, pasi objekti i Komisionit është vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit. Në nenin 42 të ligjit nr. 84/2016 përcaktohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale, duke bërë referencë në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në nenit 77/ë të ligjit nr.

96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” një nga burimet e vlerësimit janë edhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit.

25. Analizimi i 10 dosjeve të subjektit për periudhën 2015 – 2016

25.1. Komisioni, në mbledhjen e datës 10.5.2021, vendosi administrimin në total të 10 vendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga të cilat 5 vendime për mosfillimin e procedimit penal dhe 5 vendime për pushimin e procedimit penal për periudhën 2015 – 2016. Përzgjedhja e procedimeve u bë në mënyrë rastësore nga statistikat e nxjerra për hedhjen e shortit profesional. Në datën 17.5.2021, me shkresën nr. *** prot., Komisioni i kërkoi Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë fashikujt penalë të 10 procedimeve të përzgjedhur. Në datën 21.5.2021, me shkresën nr. *** prot., prokuroria vendosi në dispozicion të Komisionit fashikujt e kërkuar. Nga analizimi i tyre konstatohet se:

Dosja 1 – vendimi datë 6.3.2015, për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. **/**

Në datën 9.1.2015 është regjistruar kallëzimi penal nr. **, për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “shpërdorim detyre”, parashikuar nga nenet 248 dhe 186/3 të Kodit Penal. Në po të njëjtën datë ky kallëzim i ka kaluar për trajtim subjektit të rivlerësimit.

Në dosjen penale gjendet procesverbali “për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”. Rezulton gjithashtu se gjatë hetimit subjekti ka administruar kopje të praktikës së ndjekur nga prefekti i qarkut Lezhë në lidhje me pronën objekt konflikti, si dhe informacionin nga komuna K për këtë pasuri.

Në datën 6.3.2015 subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke argumentuar se shkaqet e këtij kallëzimi janë të njëjta me ato të paraqitura në kallëzimin e vitit 2014 dhe nuk është paraqitur asnjë pretendim i ri nga kallëzuesit.

Në përfundim konstatohet se:

- i. Subjekti nuk ka zbatuar afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, pasi ka vendosur mosfillimin në tejkalim të afatit 30-ditor.
- ii. Është e paqartë se cilat kanë qenë arsyet që subjekti ka vonuar vendimmarrjen, për sa kohë argumenton se shkaqet e këtij kallëzimi janë të njëjta me ato të paraqitura në kallëzimin e vitit 2014 dhe nuk është paraqitur asnjë pretendim i ri nga kallëzuesit.

Në lidhje me këto dy konstatime, subjekti sqaroi se vendimi i mosfillimit është marrë vetëm 27 ditë pas afatit të parashikuar në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, dhe për më tepër, së dyti, mosrespektimi i këtij afati nuk ka sjellë asnjë pasojë. Subjekti pretendon se udhëzimi nr. 241, datë 21.11.2005, i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 9.6.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, nuk është nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe nuk është i vlefshëm. Subjekti pretendon se ka qenë e nevojshme dhe e dobishme kryerja e verifikimeve të plota mbi rrethanat e pretendimeve të kallëzuesit dhe hetimet e mëparshme që ishin zhvilluar. Prandaj, pavarësisht

se faktet mbi të cilat është mbështetur vendimi i mosfillimit kanë ekzistuar që në fillim të marrjes së kallëzimit, ato nuk janë ditur prej saj.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti, bazuar në nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohet se: *“Urdhurat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët”* dhe në nenin 3/c të ligjit *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, ku përcaktohet se: *“Prokurori, në çdo rast të mbështetur në ligj dhe në prova, refuzon përmbushjen e urdhrat ose të udhëzimit, që është haptazi në kundërshtim me ligjin. Refuzimi bëhet me akt të shkruar, në të cilin prokurori arsyeton shkaqet e refuzimit. Me përjashtim të rasteve haptazi në kundërshtim me ligjin, nuk përbëjnë objekt refuzimi: 3. a) vendimet e marra në rrugë hierarkike, në zbatim të ligjit procedural penal; b) urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm”*, kishte detyrimin ligjor për të zbatuar udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Gjithashtu, nuk rezulton që nga ana e saj të jetë hartuar një refuzim me akt të shkruar ndaj udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Për sa më sipër, rezulton se subjektit nuk ka zbatuar afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, pasi ka vendosur mosfillimin në tejkalim të afatit 30-ditor, si dhe ka vonuar vendimmarrjen pa arsye në lidhje me këtë procedim, duke treguar aftësi dhe sjellje të cekëta, të cilat konsiderohen si mangësi profesionale.

Dosja 2 – vendimi datë 20.11.2015, për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. */****

Në datën 3.11.2015 është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, për veprën penale të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, *“dëmtime të tjera me dashje”*¹⁰. Në po të njëjtën datë ky kallëzim i ka kaluar për trajtim subjektit të rivlerësimit.

Bazuar në procesverbalin për kallëzimin e veprës penale datë 30.10.2015, rezulton se kallëzuesi E. J ka deklaruar se: *“Në datën 30.10.2015, rreth orës 14:00, ka qenë në lokalitë e tij ku është e punësuar edhe kunata e tij. Në këtë orar ka ardhur tek lokali shtetasi N. B, i cili është ulur me dy shokë të tij dhe ka konsumuar verë me disa meze. Z. E. J ka debatuar me z. N. B, pasi ai kishte filluar të fliste me zë të lartë dhe fjalë fyese. Në momentin që z. J ka dalë jashtë në pistën e lokalitë e ka goditur me grusht në kokë z. B dhe më pas është larguar nga lokali”*.

Pas marrjes së kallëzimit nga OPGJ-ja janë kryer veprimet hetimore, si vijon:

- Në datën 30.10.2015 është mbajtur procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, ku shtetasi E.J ka bërë të njëjtën deklaratë si në kallëzimin penal.
- Në datën 30.10.2015 është mbajtur procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, ku shtetasi N.B ka mohuar të ketë goditur me grusht shtetasin E.J.
- Në datën 30.10.2015 është mbajtur procesverbali i këqyrjes së personit, të shtetasit E. J.
- Në datën 30.10.2015 është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor.

¹⁰ Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, përbën kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj.

- Në datën 30.10.2015 është nxjerrë akt/dëshmia mjeko-ligjore nr. ***, sipas së cilës dëmtimet tek shtetasi E. J konsiderohen si të parëndësishme.

Në datën 20.11.2015 subjekti ka vendosur “mosfillimin e procedimit penal”, duke argumentuar se kemi të bëjmë me veprë penale të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, “dëmtime të tjera me dashje”, e cila, bazuar në nenin 59, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale¹¹, është veprë që ndiqet me ankim të drejtpërdrejtë në gjykatë nga i dëmtuari nga vepra penale. Në këto rrethana procedimi penal nuk mund të fillojë.

Në dosjen penale mungon njoftimi i vendimit të mosfillimit kallëzuesit, detyrim i parashikuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale.

Lidhur me këtë konstatim, subjekti, pas dërgimeve të rezultateve të hetimit, sqaroi se fakti që në dosje nuk është administruar akti i njoftimit të kallëzuesit është një pakujdesi e administratës së prokurorisë. Prokurori, në momentin që dorëzon dosjen e pushuar dhe të mosfilluar te drejtuesi për arkivim, nuk ka më disponibilitetin e saj, e cila menaxhohet nga pjesa e administratës.

Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale në lidhje me njoftimin e vendimit. Pavarësisht faktit që njoftimi kryhet nga sekretaria, është detyrë e prokurorit të mbikëqyrë dërgimin pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit. Në rastin kur vendimi nuk i njoftohet menjëherë palëve sjell si pasojë cënimin e të drejtës së tyre për të ushtruar ankim, parashikuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar njohuri, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale. Gjithashtu, subjekti nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve, si dhe nuk ka aftësi për të administruar dosjen të cilat konsiderohen si mangësi profesionale.

Dosja 3 – vendimi datë 11.2.2016, për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. */2016**

Në datën 25.1.2016 është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, për veprën penale të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal “dëmtime të tjera me dashje”. Në datën 26.1.2016 ky kallëzim i ka kaluar për trajtim subjektit të rivlerësimit.

Bazuar në procesverbalin për kallëzimin e veprës penale datë 22.1.2016, rezulton se kallëzuesi J. Z ka deklaruar se: *“Ka qënë në një lokal llotu sport, ku pronar është shtetasi A. P. Ka konsumuar një teke raki dhe kafe. Ka qënë paksa i rënduar, pasi ka konsumuar disa gota alkool dhe ka sharë e ofenduar qeverinë... Në këtë kohë ka ardhur pronari i lokalit, shtetasi A. P, i cili e ka shtyrë, ndërsa dy persona të tjerë, si dhe një djalë që punon te skedinat e kanë qëlluar me shkelma e grushte”.*

Pas marrjes së kallëzimit nga OPGJ-ja janë kryer veprimet hetimore, si vijon:

¹¹ Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92 dhe 112 paragrafi i parë, nenet 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

- Në datën 15.9.2015 (data është lapsus) është mbajtur procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, ku shtetasi J. Z ka bërë të njëjtën deklaratë si në kallëzimin penal.
- Në datën 22.1.2016 është mbajtur procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, ku shtetasi A.P ka deklaruar se shtetasi J.Z ka qenë në lokalin e tij, kishte qenë i pirë dhe ka filluar të ofendojë dhe të shajë. Nipi i tij, i punësuar si kamerier, ka tentuar ta nxirrte jashtë së bashku me një shokun e tij I. C. Kur kanë kaluar derën shtetasi Z ka tentuar të godasë nipin e tij dhe e ka kapur prej xhupi, duke ia grisur. Pas kësaj nipi i tij e ka shtyrë dhe ka parë se shtetasi Z është përplasur me një vazo lulesh. Ai ka ndërhyrë ku ka tërhequr nipin dhe shokun e tij, dhe shtetasi Z e ka shoqëruar deri te rruga kryesore. Shtetasi P ka mohuar se e ka goditur njeri shtetasin Z.
- Në datën 22.1.2016 është mbajtur procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, ku shtetasi E.P ka mohuar të ketë goditur shtetasin Z. Ai deklaron se kur e ka nxjerrë jashtë, shtetasi Z ka tentuar ta godasë dhe i ka grisur xhupin, në këtë moment ai e ka shtyrë me sa fuqi kishte dhe pa që u përplas me një vazo. Pas kësaj ka ndërhyrë xhaxhai i tij.
- Në datën 22.1.2016 është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor.
- Në datën 22.1.2016 është nxjerrë akt/dëshmia mjeko-ligjore nr. ***, sipas së cilës dëmtimet tek shtetasi J. Z hyjnë në kategorinë e rrahjes.

Në datën 11.2.2016 subjekti ka vendosur “mosfillimin e procedimit penal”, duke argumentuar se kemi të bëjmë me vepër penale të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, “dëmtime të tjera me dashje”, e cila, bazuar në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale, është vepër që ndiqet me ankim të drejtpërdrejtë në gjykatë nga i dëmtuari nga vepra penale.

Në dosjen penale gjendet njoftimi i vendimit të mosfillimit.

- i. Konstatohet se në pjesën arsyetuese të vendimit, subjekti ka cituar gabim emrin e personit që ka kryer kallëzimin, ndërsa në dispozitivin e vendimit ka cituar gabim numrin e kallëzimit penal.
- ii. Konstatohet se subjekti nuk ka hetuar në lidhje me faktin nëse shtetasi P ushtronte në mënyrë të paligjshme aktivitetin e llotos sportit (subjekti në vendimin e mosfillimit deklaron se shtetasi Z ka shkuar në një lokal llotos sport), duke qenë se ai ishte proceduar më parë nga subjekti me procedimin nr. ***/2015 (trajtuar më lart) për një fakt të tillë dhe kishte mohuar që ushtronte këtë aktivitet.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se sa i përket citimit të gabuar të emrit të kallëzuesit në një vend në arsyetim (nga 4 vende ku citohet), ai është një gabim njerëzor që i ndodh gjithkujt nga ngarkesa në punë dhe nuk ka asnjë ndikim në të. Po njësoj është edhe citimi i gabuar në dispozitivin e numrit të regjistrimit të kallëzimit penal në fjalë. Sa i përket përfundimit të Komisionit se nuk ka hetuar shtetasin A. P për veprën “organizim i lotarive të palejuara”, sqaron se në asnjë akt të këtij procedimi nuk ka rezultuar se qoftë kallëzuesi apo ndonjë person tjetër ka qenë duke luajtur lojëra fati apo baste sportive etj. në atë ambient dhe as se kishte ndonjë pajisje që shërbente për një qëllim të tillë. Fakte të tilla nuk janë referuar as nga punonjësit e policisë të cilët kanë marrë kallëzimin në lidhje me rastin. Kallëzuesi ka shkuar në këtë lokal për të konsumuar alkool dhe rezulton se edhe personat e tjerë kanë qenë duke pirë

kafe apo alkool dhe jo duke luajtur lojëra fati. Fakti i thjeshtë se ky lokal bar-kafe është quajtur nga kallëzuesi J.Z si “loto sport”, nuk është fakt i mjaftueshëm për të filluar ndonjë procedim penal, pasi ky cilësim i tij ka qenë tangent dhe nuk dihet se nisur nga çfarë informacioni apo botëkuptimi e ka përshkruar në atë mënyrë. Ajo që ka rëndësi thelbësore është se ky kualifikim i këtij lokali si “loto sport” nuk është shoqëruar me ndonjë të dhënë apo *indicie* që të sillte informacion thelbësor për ushtrimin e një aktiviteti të tillë të paligjshëm nga pronari i tij. Gjithashtu, nuk ka qenë lokal me tabelë “loto sport”, për më tepër që kallëzuesi ka qenë nën efektin e alkoolit dhe në kallëzimin e tij ka thënë se i kishin vjedhur edhe telefonin, i cili pas kërkimeve të policisë ishte gjetur rrugës prej tij kur kishte lëvizur pas daljes nga lokali. Fakti se pronari i këtij lokali ishte proceduar më parë prej saj me procedimin nr. **/2015, për një fakt të tillë dhe kishte mohuar që ushtronte këtë aktivitet, nuk është argument që ndaj tij të fillonte sërish një procedim i tillë penal pa asnjë provë për një fakt të tillë (ndërkohë që i mëparshmi ishte pushuar, megjithëse kishte pasur disa *indicie* fillestare).

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse.

Dosja 4 – vendimi datë 26.7.2016, për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. */2016**

Në datën 12.7.2016 është regjistruar kallëzimi penal i shtetasit A. N, ardhur në prokurori me nr. ***, datë 30.6.2016.

Në datën 14.7.2016 ky kallëzim i ka kaluar për trajtim subjekti të rivlerësimit.

Bazuar në kallëzimin penal të shtetasit A. N, rezulton se ai ka kallëzuar për shpërdorim detyrë punonjës in e Komisarariatit të Policisë Lezhë shtetasin I.K, duke pretenduar sa nga ana e tij janë kryer veprime abuzive, duke i vënë gjobë pa të drejtë.

Pas marrjes së kallëzimit nga OPGJ-ja janë kryer veprimet hetimore, si vijon:

- Në datën 7.7.2016 është mbajtur procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, ku shtetasi A. N ka bërë të njëjtën deklaratë si në kallëzimin penal.
 - Në datën 7.7.2016 është mbajtur procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, ku shtetasi I. K ka deklaruar se shtetasi A. N ka tentuar me mjetin e tij të parakalojë një mjet tjetër. Në momentin që e pa ndaloi veprimin dhe u fut pas mjetit që ishte në lëvizje më përpara. Për këtë lëvizje i ka vënë gjobë për manovër të gabuar. Për vendosjen e gjobës ai është bazuar në nenin ***/2015 të Kodit Rrugor.
 - Në datën 26.7.2016 është mbajtur procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së provave materiale, duke u administruar procesverbali i konstatimit të shkeljes (gjoba) datë 22.6.2016, ku shkelës rezulton shtetasi A.N.
 - Në datën 26.7.2016 oficeri i policisë gjyqësore ka përpiluar informacionin mbi faktet dhe provat e kallëzimit penal, duke sugjeruar mosfillimin e kallëzimit penal.
- Po në këtë datë, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke argumentuar se nuk jemi në kushtet e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe as në kushtet e ndonjë vepre tjetër penale.

Konstatohet se subjekti, ndër të tjera, ka vendosur si bazë ligjore nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale (që ka të bëjë me të dëmtuarin akuzues), i cili nuk përputhet me argumentet

e paraqitur nga subjekti në pjesën arsyetuese të vendimit, si dhe me veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

Lidhur me këtë konstatim, subjekti sqaron se bëhet fjalë për një gabim material krejtësisht të parëndësishëm nga ngarkesa në punë dhe nga një volum dosjesh i të njëjtës natyrë që konfondonen dhe nuk sjell asnjë ndikim në vendim, për më tepër që në të është cituar si bazë ligjore neni 290/1, germa “ç”, dhe neni 291 i Kodit të Procedurës Penale për mosfillimin e procedimit penal. Arsyetimi ka qenë i saktë, ndërsa referenca e gabuar për shkak të lapsusit njerëzor.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse.

Dosja 5 – vendimi datë 8.10.2016 për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal nr. */2016**

Në datën 8.9.2016 është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, për veprën penale të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, në bazë të materialeve të ardhura nga Komisariati i Policisë Lezhë.

Në datën 8.9.2016 ky kallëzim i ka kaluar për trajtim subjektit të rivlerësimit.

Në datën 7.9.2016 Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë ka filluar procedimin penal në gjendje të lirë ndaj shtetasit F. M, pasi duke drejtuar automjetin e tij ka shkaktuar aksident me pasojë dëmtimin e shtetasës F.R.

OPGJ-ja ka kryer veprimet hetimore, ku në përfundim ka rezultuar se shtetasi F.M ka qenë fajtor për shkaktimin e aksidentit, por nuk ka qenë në gjendje të dehur dhe bazuar në akt/dëshminë mjeko-ligjore nr. ** tek shtetasja F.R dëmtimet e shkaktuara hyjnë tek dëmtime të lehta, pa pasoja.

Në datën 8.10.2016 subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke argumentuar se nuk jemi para veprës penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal¹², pasi nuk plotësohen kushtet ligjore të nenit 290 të këtij kodi, që shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor të ketë shkaktuar vdekjen, plagosjen e rëndë të një personi ose plagosjen e lehtë të disa personave. Është e paqartë se pse vendimi i mosfillimit i është njoftuar shtetasit F. M dhe nuk i është njoftuar të dëmtuarës.

Lidhur me këtë konstatim, subjekti sqaron se neni 291/2 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se vendimi i mosfillimit u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, pasi subjekti që mund të bëjë ankim ndaj një vendimi të tillë ka qenë vetëm kallëzuesi dhe jo i dëmtuari nga vepra penale që nuk është kallëzues. Vetëm me ndryshimet e pësuara me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017 (botuar në fletoren zyrtare nr. 97, datë 5.5.2017) është rritur roli i të dëmtuarit në procedimin penal dhe të drejtat e tij, duke u shtuar në nenin 291/2 edhe detyrimi për njoftimin e vendimit të mosfillimit edhe viktimës, i cili ka të drejtë që të ankojë

¹² Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen e një personi, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në njëzet vjet.

këtë vendim sikurse kallëzuesi. Gjithsesi, sqaron se në disponimin në këtë vendim subjekti është shprehur që vendimi t'u komunikohet palëve të interesuara dhe nga titullari i prokurorisë ky vendim i është komunikuar vetëm kallëzuesit.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse.

Dosja 6 – vendimi datë 25.3.2015, për pushimin e procedimit penal nr. **/2015

Në datën 14.1.2015 subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “plagosje e rëndë nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 91 i Kodit Penal.

Nga fashikulli penal konstatohet se:

- Në datën 11.1.2015 ka shkuar i plagosur në Spitalin Rajonal të Lezhës shtetasi E. R, i cili është punonjës policie në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Elbasan.
Ky shtetas ka deklaruar se është vetëplagosur aksidentalisht me armën e tij të shërbimit.
 - Bazuar në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes rezulton se në vendin e ngjarjes është gjendur një predhë me kalibër 7.62 mm.
 - Bazuar në procesverbalin për sekuestrimin e sendeve, datë 11.1.2015, në cilësinë e provës materiale është sekuestruar arma e tipit TT, me nr. ***, e vitit 1967, nga shtetasi E. R.
Në fashikull gjendet edhe vendimi për vleftësimin e sekuestros që mban datën 11.1.2015.
- i. Ky vendim nuk rezulton të jetë i firmosur nga subjekti i rivlerësimit.
 - ii. Gjithashtu është e paqartë se si subjekti e ka hartuar këtë vendim në datën 11.1.2015, ndërkohë që urdhri për regjistrimin e procedimit është i datës 14.1.2015.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se sa i përket datës së vlerësimit ajo është e drejtë, pasi vlerësimi i sekuestros ka një afat maksimal prej 48 orësh dhe nuk ka të bëjë me regjistrimin e procedimit, i cili mundet që edhe të mos regjistrohet fare (p.sh. në rastet e lirimit të menjëhershëm kur fakti nuk përbën vepër penale por sekuestro ka qenë i ligjshëm). Në rastin kur një OPGJ kryen një sekuestro, ajo i paraqitet domosdoshmërisht prokurorit për vlerësim menjëherë, ndërkohë që materialet e këtij procedimi janë referuar në Prokurorinë e Rrethit Lezhë në datën 13 (pra dy ditë më vonë). Prandaj, nëse do të pritej ardhja e materialeve referuese dhe regjistrimi i procedimit penal (që nuk janë askund të lidhura ligjërisht me njëra-tjetrën), atëherë sekuestroja do të binte pasi nuk ishte vlerësuar brenda afatit ligjor. Oficeri i policisë gjyqësore paraprakisht, pasi bën një procesverbal sekuestro, i dërgon prokurorit të gatshëm një kopje të vendimit me qëllim vleftësimin ose jo brenda afatit 48 orë. Vendimi i vleftësimit, përveçse administrohet në dosje, i drejtohet menjëherë edhe oficerit që ka bërë sekuestron, në mënyrë që marrja e provës të konsiderohet proceduralisht e rregullt. Sa më sipër (përveç rasteve të flagrancës), vleftësimi i sekuestros ose i kontroleve bëhet në të shumtën e rasteve pa u referuar materiali në prokurori dhe eventualisht pa u regjistruar një procedim penal. Sa i përket (mos)nënshkrimit të vendimit të vleftësimit të sekuestros, kjo ka ndodhur nga ngutja në kopjen e vendimit që është mbajtur në dosjen e prokurorisë, por që padyshim është nënshkruar kopja e vlerësimit që i ka shkuar policisë (e cila ka pasur aktet procedurale në këtë moment procedural, pa u referuar ende vepra penale).

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se në dosjen e procedimit penal vendimi për vleftësimin e sekuestros nuk është i firmosur. Subjekti duhet të ishte treguar e

kujdesshëm për të plotësuar dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe konform Kodit të Procedurës Penale.

Për sa më sipër, subjekti ka mungesë aftësish në administrimin e dosjes, të cilat konsiderohen si mangësi profesionale.

- Bazuar në aktin nr. ***, të ekspertimit tekniko-balistik, datë 20.1.2015, rezulton se predha objekt ekspertimi është qitur nga arma e zjarrit pistoletë tip TT, model **, kalibër ** mm, me nr. ***.

Në aktekspertim përcaktohet se evidentohet prania e nitritive dhe nitrateve në tytën e armës. Ndërkohë, në tabelat fotografike në foton e pamjeve të testit të reaksionit kimik për praninë e nitritive dhe nitrateve në armën objekt ekspertimi përcaktohet se nuk rezultoi ngjyrosje blu në formë rrjedhjesh karakterisitike, kjo për praninë e nitritive dhe nitrateve në përbërje të djegies së barutit.

- Bazuar në aktin nr. ***, datë 15.1.2015, ekspertim kimik i shiritave ngjitës dhe fizik i tamponëve për marrje modeli të mbetjeve të qitjes rezulton se në duart e shtetasit E. R nuk u evidentuar prania e nitritive dhe nitrateve.

Në lidhje me këtë konkluzion, ky shtetas ka deklaruar se duart i ishin bërë me gjak dhe ia ka pastruar një infermiere në spital dhe kjo është arsyeja që nuk gjenden gjurmë.

- Bazuar në aktin nr. ***, datë 17.3.2015, ekspertim teknik-kimik teshash, konkludohet se në bluzën objekt ekspertimi u evidentua prania e nitriteve dhe nitrateve, ndërsa në teshat e tjera nuk u evidentua prania e nitritive dhe nitrateve.

Në teshat objekt ekspertimi janë evidentuar dëmtime nga kalimi i një predhe të qitur me armë zjarri në distancë të afërt, gati me puqitje në dëmtimin D1 (vrime e hyrjes) dhe dalje në dëmtimet D2, D3, D4.

Ky konkluzion i ekspertit është i paqartë, pasi një vrimë hyrëse ka vetëm një vrimë dalje dhe jo tre.

- Bazuar në aktin/dëshminë mjeko-ligjore nr. **, datë 19.1.2015, rezulton se ka dy plagë në trupin e shtetasit E. R.
 - i. Plagë thorako abdominale djathtas (tejshpuese) me vrimë hyrëse në pjesën e kraharorit, me dimension 0,5cm x 0,5cm dhe me dalje në regjionin e *spina iliaca anterior superior* të djathtë me madhësi afërsisht 1,5 x 1,5cm; dhe
 - ii. Plaga tjetër në pjesën inguinale të djathtë, në pjesën e sipërme të kofshës, me madhësi afërsisht 1,5 x 1,5cm (tejshpuese) dhe me dalje në 1/3 e mesme të kofshës së djathtë në pjesën anësore të jashtme të saj, me përmasa afërsisht 1,5 x 1,5cm.

Sipas aktekspertimit dëmtimet e mësipërme hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve që kanë sjellë për pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme në punë, në masën mbi 9 ditë.

Në datën 25.3.2015 subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal, duke argumentuar se nga fashikulli i procedimit penal ka rezultuar se shtetasi E. R nuk ka pasur konflikt me ndonjë person tjetër, por ka plagosur veten me armën e tij të shërbimit në mënyrë aksidentale.

Në lidhje me këtë procedim konstatohet se:

- i. Subjekti nuk rezulton të ketë analizuar se cila ka qenë arsyeja që në trupin e shtetasit E. R, sipas aktekspertimit mjeko-ligjor gjenden dy plagë hyrëse-dalëse, ndërkohë që është qitur vetëm një predhë.
- ii. Subjekti duhet të kishte kërkuar kryerjen e një akti riekspertimi mjeko-ligjor për të qartësuar se sa plagë kishte në trupin e shtetasit E. R, duke u saktësuar se sa vrima hyrëse dhe dalëse kishte në trupin e tij, si dhe nga çfarë lloj arme zjarri ishin shkaktuar këto plagë.
- iii. Subjekti duhet të kishte kërkuar një akt riekspertimi teknik-kimik teshash për të përcaktuar sa plagë rezultonin në trupin e shtetasit E. R, pasi ka një mospërputhje midis vrimave hyrëse dhe dalëse (1 hyrëse dhe tre dalëse).
- iv. Subjekti duhet të kishte ripyetur shtetasin E. R në lidhje me faktin se pse në trupin e tij gjendeshin dy plagë dhe jo një plagë.
- v. Në vendngjarje është gjetur predha dhe nuk është gjendur gëzhoja e predhës së qitur, ndërkohë që shtetasi E. R ka deklaruar se gëzhoja ose ka qenë në teshat e tij, ose ka rënë në tokë tek makina.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se nuk është aspak e vërtetë që teorikisht një vrimë hyrëse mund të korrespondojë domosdoshmërisht vetëm një vrimë dalëse (pasi mundet që predha, pas kontaktit me inde të forta, të ndahet apo të marrë përpara inde të tjera të forta dhe të shkaktojë disa vrima daljeje). Ky është një konkluzion shumë i shpeshtë në plagët me armë zjarri. Gjithsesi, ky nuk është rasti konkret, pasi në rastin në shqyrtim duhet të dallohet numri i plagëve në aktekspertimin mjeko-ligjor me dëmtimet në tesha. Në rastin e mësipërm bëhet fjalë për dëmtimet në tesha, të cilat nuk janë ekzaktesisht e njëjta gjë sikurse dëmtimet në trupin e shtetasit E. R. Kjo pasi vrimat D2, D3 dhe D4 janë e njëjta vrimë e pasqyruar në tre rroba të ndryshme që janë bluza, pantallonat dhe mbathjet e tij... Organi procedues mund të urdhërojë kryerjen e një akti të ri ekspertimi për të dhënë përfundime shkencore mbi ndodhi apo fenomene me karakter teknik, por jo që eksperti të ndryshojë gjendjen e fakteve. Dëmtimet e shkaktuara tek shtetasi E.R janë përshkruar në kartelën e tij klinike dhe nuk mund të ndryshohen nga asnjë ekspert tjetër mjeko-ligjor... Duke parë përmasat e plagëve dhe drejtimin e buzëve të tyre, konstatohet se plaga e parë në gjoks është plaga e parë e shkaktuar nga një qitje me puqitje dhe më pas ka dalë në pjesën e legenit përpara dhe ka hyrë sërish në kofshë duke dalë anash saj. Kjo trajektore e predhës dhe e indeve të forta është e qartë dhe e padiskutueshme, jo vetëm për arsyet e cituara më lart për mënyrën se si janë fiksuar këto prova, por edhe për përputhjen e tyre me të gjitha provat e tjera të shumta në këtë hetim. Kështu, është e qartë (nga shkenca e mjekësisë ligjore) se e vetmja plagë hyrëse nga një predhë e dalë nga një armë zjarri është vetëm plaga e parë në kraharor me përmasa 0,5 x 0,5 cm, pasi plagët e tjera janë me përmasa të mëdha dhe nuk mund të shkaktohen nga një predhë e drejtpërdrejtë. Pra, ky fakt, i cili përputhet me vetëm një predhë të gjetur në vendngjarje dhe me shumë deklarime se kanë dëgjuar vetëm një të shtënë, nuk lë më vend për dyshime. Hetimi paraprak për këtë çështje ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm dhe asnjë provë e rëndësishme që mund të ndikonte në këtë procedim nuk është lënë pa u marrë... Në vlerësimin e saj në çështjen konkrete ka disa prova të cilat në harmoni me njëra-tjetrën konfirmojnë faktin se plagosja e shtetasit E. R është kryer aksidentalisht prej vetë atij me armën e shërbimit. Kjo mbështetet në deklaratimet e tij dhe të shumë personave të pranishëm në vendngjarje, si dhe nga aktekspertimi balistik, i cili ka provuar se predha e gjetur në vendngjarje ka dalë nga arma e tij me leje. Po ashtu, edhe

drejtimi i qitjes dhe karakteristikat e plagëve përputhen me shpjegimet e tij. Për rrjedhojë, në kushte të tilla, çdo lloj interpretimi tjetër që mund t'i bëhej plagëve dhe teshave të tij, ato do të ishin të paafta që të krijonin një konflikt mes tij dhe një personi tjetër dhe as të bënin që ajo predhë të mos kishte dalë nga arma e tij e zjarrit.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti deklaron “duke parë përmasat e plagëve dhe drejtimin e buzëve të tyre”, ndërkohë në fashikullin penal nuk gjendet asnjë foto e këtyre plagëve në mënyrë të tillë që subjekti të fliste me siguri në lidhje me përmasat e plagëve, por edhe drejtimin e tyre. Subjekti deklaron se “plaga e parë në gjoks është plaga e parë e shkaktuar nga një qitje me puqitje dhe më pas ka dalë në pjesën e legenit përpara dhe ka hyrë sërish në kofshë duke dalë anash saj”. Bazuar në deklaratimet e subjektit rezulton se predha ka dalë në pjesën e legenit për të hyrë sërish në kofshë. Ky deklaram i subjektit nuk është i mbështetur në asnjë provë, për më tepër, nëse predha del ajo nuk mund të hyjë sërish në trup dhe aq më tepër nga pjesa e legenit në pjesën e kofshës të cilat kanë një distancë shumë të afërt me njëra-tjetrën. Gjithashtu, ky deklaram i subjektit nuk mbështetet as nga aktekspertimi mjeko-ligjor, nga ku rezulton se kemi të bëjmë me dy plagë tejshpuese. Në kushtet kur në aktekspertim nuk qartësohej nëse kishim të bënim vetëm me një plagë me vrimë hyrëse dhe tre vrima dalëse, subjekti duhej të kishte kërkuar rieskupertimin mjeko-ligjor për të qartësuar se sa plagë kishte në trupin e shtetasit E. R, duke u saktësuar se sa vrima hyrëse dhe dalëse kishte në trupin e tij, si dhe nga çfarë lloj arme zjarri ishin shkaktuar këto plagë. Subjekti duhet të kishte ripyetur shtetasin E. R në lidhje me faktin se pse në trupin e tij gjendeshin dy plagë dhe jo një plagë. Subjekti nuk rezulton të ketë analizuar në vendimin e pushimit se cila ka qenë arsyeja që në trupin e shtetasit E. R, sipas aktekspertimit mjeko-ligjor, gjenden dy plagë hyrëse-dalëse, ndërkohë që është qitur vetëm një predhë. Gjithashtu, subjekti nuk ka analizuar se pse në vendngjarje është gjetur predha dhe nuk është gjendur gëzhoja e predhës së qitur, ndërkohë që shtetasi E. R ka deklaruar se gëzhoja ose ka qenë në teshat e tij, ose ka rënë në tokë tek makina. Subjekti, në lidhje me këtë konstatim dhe pas kalimit të barrës së provës, nuk ka dhënë shpjegime.

Duke qenë se nga analizimi në tërësi i provave mund të ngrihen dyshime që shtetasi E.R mund të jetë plagosur dhe jo vetëplagosur, bazuar kjo në faktin që kishim të bënim me dy plagë tejshpuese, predha rezulton e gjetur në krahun e majtë të automjetit ndërkohë dëmtimet e shtetasit janë shkaktuar në pjesën e djathtë, shtetasi K. P që kishte qenë në tavolinë me z. R ka deklaruar se nuk ka pasur dijeni çfarë ka ndodhur dhe ka kaluar në spital thjesht për kureshtje, si dhe nuk rezulton që të jenë gjetur gëzhoja në vendin e ngjarjes, nga ana e subjektit duhej të ishin kryer veprime të mëtejshme hetimore.

Komisioni, në lidhje me këtë procedim, konstaton se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme, duke treguar njohuri gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, të cilat konsiderohen si mangësi profesionale.

Dosja 7 – vendimi datë 25.5.2015, për pushimin e procedimit penal nr. */2015**

Në datën 30.1.2015 është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal, “përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”.

Subjekti i rivlerësimit është ngarkuar me hetimin e këtij procedimi përmes vendimit datë 9.4.2015, të drejtuesit të prokurorisë, sipas së cilit është bërë zëvendësimi i prokurorit.

Ky procedim ka nisur mbi bazën e kallëzimit të kryer në datën 29.4.2014, nga shtetasi Gj. D. Ai ka pretenduar se është telefonuar nga një person me numër telefonik privat, i cili i kërkonte të ndikonte tek e bija me qëllim që të ribashkohej me ish-bashkëshortin e saj.

Përmes informacionit të marrë gjatë hetimit, nga kompanitë telefonike celulare është bërë i mundur identifikimi i personit që kryente këto telefonata.

Në procesverbalin “për ankimin e të dëmtuarit nga vepra penale”, mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore në datën 14.5.2015, shtetasi Gj. D ka deklaruar se tërheq ankimin e tij.

Me vendimin datë 25.5.2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal, duke argumentuar se ndodhemi përpara rastit kur i dëmtuari nga vepra penale e tërheq ankimin me vullnetin e tij të lirë, bazuar në nenin 284/1 të Kodit të Procedurës Penale¹³.

Dosja 8 – vendimi datë 20.11.2015, për pushimin e procedimit penal nr. */2015**

Subjekti, në datën 9.10.2015, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal, “shkatërrimi i pronës me zjarr”.

Subjekti, në urdhrin e regjistrimit, ka një lapsus në nenin e Kodit Penal, pasi ajo ka cituar nenin 150 të këtij kodi, ndërkohë që për veprën penale të përcaktuar në urdhrë është neni 151 i Kodit Penal.

Nga fashikulli konstatohet se materiali hetimor ka ardhur që në datën 11.8.2015 në Prokurorinë e Rrethit Lezhë dhe i ka kaluar subjektit po në datën 11.8.2015.

Në datën 20.11.2015 subjekti, bazuar në ekspertimin piroteknik dhe deklaratimet e pronarit të dyqanit, ka vendosur pushimin e procedimit penal, pasi ka argumentuar se nuk ka asnjë dyshim të bazuar për të iniciuar një procedim penal të “shkatërrimit të pronës me zjarr”.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti për dy muaj nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me këtë material hetimor, duke mos e regjistruar, si rrjedhojë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale dhe udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se nuk është e vërtetë se nuk është kryer asnjë veprim hetimor, pasi veprimet e para hetimore dhe vendimi për kryerjen e aktekspertimit teknik është marrë nga OPGJ-ja para se çështja të referohej në prokurori dhe, siç rezulton nga dosja, paraqitja e këtij akti pranë prokurorisë është zvarritur nga sektori i PMNZSH-së, duke u përcjellë nga prefekti vetëm në datën 16.11.2015. Prokuroria ka kërkuar dorëzimin e këtij akti në datat 8.9.2015 dhe 9.10.2015 dhe është paraqitur vetëm më 16.11.2015. Pra, shkak i kësaj vonese është i motivuar plotësisht dhe s’ka të bëjë me punën e prokurorisë. Neni 287 i Kodit të Procedurës Penale të kohës nuk parashikonte afate të prera dhe strikte për regjistrimin e një çështjeje penale dhe për vendosjen e mosfillimit të saj.

¹³ Për veprat penale të parashikuara nga nenet 89, 102, paragrafi i parë, 105, 106, 130, 239, 240, 241, 243, 264, 275 dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit.

2. Ankimi bëhet nga i dëmtuari te prokurori ose në policinë gjyqësore me anën e një deklarate, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, shfaqet vullneti që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti i referohet mosfillimit të procedimit, ndërkohë që ka vendosur pushimin e saj. Nga ana e subjektit rezulton se për dy muaj nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me këtë material hetimor, duke mos e regjistruar, si rrjedhojë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale dhe udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar njohuri, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

Dosja 9 – vendimi datë 6.10.2016, për pushimin e procedimit penal nr. */2016**

Subjekti, në datën 29.6.2016, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal, “përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”.

Nga fashikulli konstatohet se materiali hetimor ka ardhur që në datën 30.5.2016 në Prokurorinë e Rrethit Lezhë dhe i ka kaluar subjektit po në datën 30.5.2016.

Ky procedim ka nisur mbi bazën e kallëzimit të kryer në datën 25.5.2016 nga shtetasi Gj.G. Ai ka pretenduar se për një periudhë rreth tre muaj shqetësohet me telefonata nga një numër telefonik i fshehur.

Përmes informacionit të marrë gjatë hetimit nga kompanitë telefonike celulare, është bërë i mundur identifikimi i personit që kryente këto telefonata.

Në procesverbalin “për heqjen dorë nga e drejta e ankimit”, mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore në datën 6.10.2016, shtetasi Gj.G ka deklaruar se tërheq ankimin e tij.

Me vendimin datë 6.10.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal, duke argumentuar se ndodhemi përpara rastit kur i dëmtuari nga vepra penale e tërheq ankimin me vullnetin e tij të lirë, bazuar në nenin 284/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti për gati një muaj nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me këtë material hetimor, duke mos e regjistruar dhe duke vepruar në kundërshtim me nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale dhe udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Subjekti, në lidhje me këtë konstatim, ka paraqitur të njëjtat argumente si më lart.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga ana e subjektit rezulton se për 1 muaj nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me këtë material hetimor, duke mos e regjistruar, si rrjedhojë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale dhe udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar njohuri, gjykim dhe sjellje të cekëta, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj, duke u konsideruar si mangësi profesionale.

Dosja 10 – vendimi datë 8.9.2016, për pushimin e procedimit penal nr. */2016**

Subjekti, në datën 26.7.2016, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, “plagosje e lehtë me dashje”.

Nga fashikulli konstatohet se materiali hetimor ka ardhur që në datën 12.7.2016 në Prokurorinë e Rrethit Lezhë dhe i ka kaluar subjektit po në datën 12.7.2016.

Ky procedim ka nisur mbi bazën e kallëzimit të kryer në datën 9.7.2016 nga shtetasi P.P. Sipas materialit kallëzues rezulton se ky shtetas është goditur disa herë nga shtetasi E. Q.

Pas marrjes së kallëzimit nga OPGJ-ja janë kryer veprimet hetimore, si vijon:

- Në datën 9.7.2016 është mbajtur procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale ku shtetasi P.P ka bërë të njëjtën deklaratë si në kallëzimin penal.
- Në datën 9.7.2016 është mbajtur procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale ku shtetasja R.Q ka dhënë deklaratimet e saj në lidhje me ngjarjen.
- Në datën 9.7.2016 është mbajtur procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime ku shtetasi E. Q ka deklaruar se e ka goditur shtetasin P. P, pasi ai e kishte goditur me kmese dhe gurë.
- Në datën 9.7.2016 është mbajtur procesverbali i këqyrjes së jashtme të shtetasit E. Q dhe P.P.
- Në datën 9.7.2016 është mbajtur procesverbali i kontrollit të vendeve për banesat e dy shtetasve të mësipërm.
- Janë administruar të dhënat e sistemit *TIMS*, si dhe kartela klinike.
- Është bllokuar arma e gjahut që e kishte me leje shtetasi P.P.
- Në datën 9.7.2016 është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor.
- Në datën 9.7.2016 është nxjerrë akt/dëshmia mjeko-ligjore nr. ***, sipas së cilës dëmtimet tek shtetasi P. P hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të cilat kanë sjellë për pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi 9 ditë.
- Në datën 20.7.2016 është nxjerrë akt/dëshmia mjeko-ligjore nr.***, sipas së cilës dëmtimet tek shtetasi E. Q hyjnë në kategorinë e rrahjes.
- Në datën 14.7.2016 është mbajtur procesverbali për ankimin e të dëmtuarit nga vepra penale ku shtetasi P deklaroi se kërkon ndjekjen penale ndaj shtetasit Q.
- Në datën 8.9.2016 shtetasi P ka hequr dorë nga e drejta e ankimit.

Me vendimin datë 8.9.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve të procedimit penal, duke argumentuar se shtetasi P. P ka hequr dorë nga ankimi, ndërkohë, dëmtimet tek shtetasi E.Q plotësojnë figurën e veprës penale të rrahjes, të parashikuar nga neni 90 i Kodi Penal, veprë e cila në bazë të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale ndiqet me ankim të drejtpërdrejtë në gjykatë nga i dëmtuari nga vepra penale.

26. Denoncimet

Komisioni ka administruar 6 denoncime nga publiku në lidhje me subjektin e rivlerësimit Riselda Fishta. Subjektit iu kalua barra e provës vetëm për denoncimin e bërë nga shtetasja V. P¹⁴.

Denoncuesja ankohet për zvarritje të hetimit nga subjekti pasi nga momenti i arrestimit të saj në datën 11.9.2020, deri aktualisht, kanë kaluar më shumë se 8 muaj dhe subjekti nuk ka përfunduar hetimin në përputhje me nenet 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale.

¹⁴ Denoncim nr. ***, datë 10.5.2021

Nga verifikimi i dokumentacioni rezulton se në datën 14.9.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendim nr. **, ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetases V. P, bërë në datën 11.9.2020, dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim paraqitje”.

Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Shkodër, e cila ka vendosur vleftësimin e paligjshëm të arrestit në flagrancë.

Për sa më sipër, rezulton se procedimi penal ka filluar në datën 14.9.2020 dhe nuk ka përfunduar ende, duke u tejkeluar afatet e parashikuara nga neni 323 i Kodit të Procedurës Penale me më shumë se 7 muaj duke iu referuar denoncimit.

Subjekti sqaroi se ka kryer veprime hetimore, si dhe janë bashkuar disa procedime së bashku me procedimin fillestar. Në datën 8.3.2021 ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga hetimi, e cila është miratuar në datën 10.4.2021.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse. Gjithashtu, për sa kohë ky procedim është në hetim, ai nuk mund të shqyrtohet nga Komisioni në zbatim të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

27. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit profesional, Komisioni çmon se subjekti ka shfaqur njohuri, aftësi dhe gjykim të cekët në punën profesionale, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e saj si prokurore, si më poshtë vijon:

- i. Subjekti, pa shkaqe të përligjura dhe në mënyrë të përsëritur, në mosfillimet e procedimeve penale ka tejkeluar afatet e marrjes së vendimeve të përcaktuara në udhëzimet nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, si dhe nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar. Subjekti, në rastet e vendimeve të mosfillimit, ka vonuar nxjerrjen e tyre në mënyrë të pamotivuar, pasi nuk janë kryer menjëherë verifikime të mundshme kur ishte e nevojshme. Subjekti ka vonuar vendimmarrjen edhe kur nuk kishte nevojë për asnjë lloj verifikimi.
- ii. Subjekti, në rastet e vendimeve të pezullimit, ka vonuar nxjerrjen e tyre në mënyrë të pamotivuar, pasi nuk ka kryer menjëherë verifikime të mundshme kur ishte e nevojshme.
- iii. Në raste të përsëritura janë zvarritur për periudha të gjata kohore dhe pa pasur arsye ligjore, hetimet paraprake. Zvarritje të tilla janë bërë për neglizhencë të subjektit, pasi ka raste që nuk i ka deleguar për kryerje të veprimeve hetimore tek oficerët e policisë gjyqësore, por edhe në raste delegimi pas sugjerimit të oficerëve të policisë gjyqësore, subjekti nuk u ka dhënë zgjidhje procedimeve për periudha të gjata kohore.
- iv. Nga ana e subjektit nuk ka vijueshmëri dhe rregullueshmëri të veprimeve hetimore për periudha të gjata kohore, pasi rezulton se nuk janë kryer veprime hetimore, si dhe megjithëse nga oficerët e policisë gjyqësore hetimet janë konsideruar të përfunduara dhe janë përpiluar relacionet përfundimtare mbi mënyrën e përfundimit të procedimit penal, subjekti, pa asnjë shkak ligjor dhe pa kryer asnjë veprim hetimor, ka vonuar për disa muaj vendimet e pushimit të procedimeve penale.
- v. Në një rast rezulton se si pasojë e moskryerjes së veprimeve hetimore dhe zvarritjes në hetim, duke mos ushtruar ndjekjen penale ndaj personit nën hetim, ky person jo vetëm që nuk është marrë në përgjegjësi penale, por është kapur sërish në flagrancë nga policia.
- vi. Ndaj të dyshuarve të hetuar me masa sigurimi “arrest në burg” apo “arrest në shtëpi”, për shkak të zvarritjeve të theksuara gjatë kryerjes së veprimeve hetimore, masat e sigurimit të

caktuara nga gjykata ndaj tyre kanë humbur fuqinë, duke bërë që të mbahen në burg pa pasur masë sigurimi në fuqi. Qëndrimi i subjektit në këto raste është në kundërshtim me parashikimin e germave “b” e “c” të pikës 1 të nenit 263/1 dhe nenit 267 të Kodit të Procedurës Penale.

- vii. Subjekti, në dy raste, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve në lidhje me afatet e paraburgimit.
- viii. Në 6 raste, emrin e personit që i atribuohet vepra penale është regjistruar me shumë vonesë, pavarësisht se në pjesën dërrmuese të rasteve ishte i qartë që në aktet e referuara nga policia gjyqësore.
- ix. Subjekti, në një rast, nuk ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit për të dyshuarin, duke vepruar në kundërshtim me nenet 228-230 të Kodit të Procedurës Penale.
- x. Në raste të përsëritura vendimet e mosfillimit dhe vendimet e pushimit të procedimeve penale nuk u janë njoftuar menjëherë personave të interesuar, duke vepruar në mënyrë të përsëritur, në kundërshtim me parashikimet e neneve 291 e 329 të Kodit të Procedurës Penale. Një pjesë e këtyre vendimeve janë mbajtur në zyrën e subjektit, duke mos iu njoftuar palëve.
- xi. Gjatë përfaqësimit të organit të akuzës në gjyq, gjatë periudhës 1.1.2012 – 1.6.2014, subjekti nuk ka marrë pjesë në gjykim, pa shkaqe të justifikuara, për 77 seanca gjyqësore, duke bërë që datat e gjykimit të caktuara nga gjykata të shtyhen në data të tjera për mosparaqitje të saj.
- xii. Subjekti ka mbajtur në zyrën e saj fashikuj hetimorë të përfunduar, pa i dërguar për kontroll te drejtuesi i prokurorisë dhe pa i hequr nga regjistri.
- xiii. Subjekti, në disa raste, nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme.

VI. KONKLUZION

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka shfaqur mangësi në aftësitë e tij profesionale, të cilat mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “b”, nenit 44/b, si dhe të nenit 60, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Pezullimin nga detyra të znj. Riselda Fishta, për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

2. Në përfundim të këtij trajnimi, pas administrimit të rezultateve të arritura nga subjekti, Komisioni do të përfundojë procesin e rivlerësimit, bazuar mbi të tria kriteret.
3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe Shkollës së Magjistraturës brenda 30 ditëve pas kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim është i paankimueshëm, bazuar në pikën 2 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Genta TAFA (BUNGO)
Relatore

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha